

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5849
E premte, 9 gusht 2019
çmimi 0.40 €

Ministri i Mbrojtjes: Tranzicioni i FSK-së do të jetë transparent

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", ISLAM PACOLLI | FAQE 4-5




AKR-ja nuk e ka problem kalimin e pragut zgjedhor

- Për mendimin tim, Aleanca
Kosova e Re (AKR) duhet të
garojë e vetme në zgjedhje

Deputeti i Aleancës Kosova e Re (AKR), Islam Pacolli, ka bërë me dije se kjo parti është e përgatitur për zgjedhje të reja kurdo që ato mbahen. Ai ka thënë se AKR-ja nuk do ta ketë problem kalimin e pragut zgjedhor. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Pacolli ka deklaruar se ende nuk është vendosur nëse kjo parti do të garojë e vetme apo në koalicion. Ai ka theksuar se AKR-ja nuk e injoron dhe nuk ka vija të kuqe për askënd. Megjithatë, sipas Islam Pacollit, AKR-ja në këto zgjedhje do të duhej të garonte e vetme. Ai ka shprehur optimizëm se puna e ndershme e AKR-së do të vlerësohet nga qytetarët

Analistët paralajmërojnë se mund të mos shpërndahej Kuvendi më 22 gusht

Subjektet politike parlamentare kanë filluar deponimin e nënshkrimeve të deputetëve të tyre për shpërndarjen e Kuvendit të Kosovës më 22 gusht, por njohësit e rrethanave politike kanë paralajmëruar mundësinë e formimit të një qeverie pa shkuar në zgjedhje të parakohshme. Ndonëse të gjitha subjektet politike kanë shprehur vullnetin e tyre për zgjedhje, analisti Vigan Qorrolli ka bërë me dije se nëse më 22 gusht 80 deputetë nuk votojnë për shpërndarjen e Kuvendit, atëherë presidentit i hapet mundësia ta provojë formimin e qeverisë së re pa shkuar vendi në zgjedhje | FAQE 3



Dita e parë e Kurban Bajramit, të dielën

FAQE 6

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË



INTERVISTË ME AKADEMIK
ALI ALIUN

AKADEMIA ËSHTË ASHTU
SI KOSOVA | F. 16

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

AKTUALE



FRIED: FURNIZIMI I SERBISË
ME ARMATIM RUS MUND TA
PRISHË EKUILIBRIN NË RAJON

F. 2

KOLLÇAKU: KJO QEVERI
DËSHTOI TA BËJË FONDIN E
SIGURIMEVE SHËNDETËSORE

F. 7

MUSTAFA: LDK-ja NUK
KA SHUMË DISPONIM PËR
KOALICIONE PARAZGJEDHORE

F. 6

EKONOMI

ZYRTARËT E AEROPORTIT THONË
SE KËRKESAT E PUNËTORËVE
JANË JOLIGJORE | F. 9

QYTETARËT QË KANË PUNUAR
NË ZVICËR PËRFITIMET
E PENSIONIT MUND T'I MARRIN
PAS 1 SHTATORIT | F. 8

KULTURË

INTERVISTË ME AKADEMIK
ALI ALIUN

AKADEMIA ËSHTË ASHTU
SI KOSOVA | F. 16

Vuçiqi për Kosovën: Na pret një vjeshtë e vështirë

BEOGRAD, 8 GUSHT - Presidenti serb Aleksandër Vuçiq ka thënë se pret një "vjeshtë të vështirë" sa i përket çështjes së Kosovës sepse ai mendon se "Perëndimi do të përpiqet ta shpejtojë zgjidhjen e problemit". Megjithatë, Vuçiqi ka përsëritur se zgjidhja nuk do të jetë e mundur nëse

Serbia nuk merr asgjë. "Unë nuk e di se cila është ideja. Ajo që unë kisha si ide u refuzua nga të gjithë. Askush nuk e pëlqeu. Le të shohim se cila është ideja juaj, sepse ende nuk e kam dëgjuar, përveçse pashë më shumë presion mbi mua. Serbia nuk mund të pajtohet me pavarësinë (e

Kosovës) nëse Serbia nuk merr asgjë", ka thënë Vuçiqi në një intervistë për mediat serbe. Ai ka theksuar se ua ka bërë të qartë të gjithë bashkëbiseduesve në bashkësinë ndërkombëtare, se nuk do të ketë zgjidhje nëse dikush mendon se Serbia duhet të poshtërohet.



Fried: Furnizimi i Serbisë me armatim rus mund ta prishë ekuilibrin në rajon

PRISHTINË, 8 GUSHT - Ish-diplomati i lartë amerikan Daniel Fried tha se një aleancë midis Serbisë dhe Rusisë nuk do të ishte e dobishme për popullin serb. "Unë nuk e di se si do të ishte e dobishme ideja që Serbia të bëhej 'varëse' ruse ose të ishte nën kontrollin e Rusisë ose pjesë e sistemit të Putinit", ka thënë Fried për "Zërin e Amerikës" në gjuhën serbe. Sipas mendimit të tij, "çështja themelore është që Serbia ta realizojë të ardhmen evropiane". "Unë nuk po flas që Serbia të bëhet aleate e Shteteve të Bashkuara. Mbase kujtimet e luftës së Kosovës janë shumë të freskëta për këtë! Nëse Serbia nuk dëshiron të blejë pajisje ushtarake amerikane, pse të mos blejë nga Franca pasi marrëdhëniet me atë

vend janë në rregull?", ka deklaruar Fried.

Rusia dorëzoi dhjetë automjete të blinduara në Serbi në fund të korrikut, të cilat presidenti serb Aleksandar Vuçiq pretendon se i ka marrë si dhuratë.

Daniel Fried thekson se pajisjet ushtarake ruse, sado të vjetruara, mund ta prishin ekuilibrin në një rajon tashme të paqëndrueshëm. "Brenda ish-Jugosllavisë, Kosova, Republika Serbe dhe Bosnje e Hercegovina nuk janë zona të qëndrueshme. Problemi është se Serbia është akoma e interesuar për t'u bërë një lloj ure midis Rusisë dhe Perëndimit ose një lloj vendi neutral dhe unë thjesht nuk e shoh se si mund të jetë kjo në interes të dikujt", ka thënë eksperti amerikan.



Eksperti i BE-së: Shqipërisë nuk i hapen negociatat në tetor



TIRANË, 8 GUSHT - "Shqipërisë nuk ka të ngjarë t'i hapen negociatat për anëtarësimin në Bashkimin Evropian as në tetor". Ky është paralajmërimi i ekspertit të njohur evropian për Ballkanin Perëndimor, Florian Bieber, sipas të cilit, skenari më i mundshëm është që në tetor negociatat të hapen vetëm me Maqedoninë e Veriut.

Në një intervistë për gazetën "Si", eksperti me origjinë nga Luksemburgu shprehet se kriza

aktuale politike në Shqipëri po shërben si një argument për vendet kritike si Franca dhe Holanda se perspektiva evropiane e Shqipërisë është në errësirë.

Bieber është një nga ekspertët më të njohur evropianë për Ballkanin Perëndimor dhe është autor i dhjetëra librave dhe artikujve që lidhen me rajonin.

Aktualisht Bieber është koordinator i Grupit Këshillimor të

Politikave për Ballkanin në Evropë dhe drejtor i Qendrës për Studimet e Evropës Juglindore në Universitetin e Grazit, në Austri. Bieber fajëson për gjendjen në të cilën ndodhet vendi të gjitha palët politike, duke thënë se qeveria nuk ka ditur si ta trajtojë krizën në vend ndërkohë që, sipas tij, opozita ka treguar se është e gatshme të rrezikojë të ardhmen evropiane të Shqipërisë.

Shqiptari i arratisur nga burgu që grabiti një bankë kapet pas shtatë vjetësh

TIRANË, 8 GUSHT - Një 35-vjeçar shqiptar është arrestuar të mërkurën, shtatë vjet pasi u arratis nga burgu i Patras, Greqi, saktësisht më 25 janar 2012. Shkak u bë grabitja e një banke në Parga të Greqisë tri ditë më parë, ku shqiptari ishte një nga dy autorët e grabitjes me armë.

Arrestimi i të arratisurit u bë i mundur në një prej rrugëve kryesore të Prevezës, ku më pas autoritetet përkatëse e identifikuan 35-vjeçarin si autorin e grabitjes dhe njëkohësisht të arratisurin e shumë viteve më parë.

Në vitin 2012, teksa vuante dënimin me 12 vjet burgim për

vjedhje, grabitje të armatosur dhe hyrje të paligjshme në vend, shqiptari përfitoi nga një pushim gjashtëditor për të mos u kthyer më në burg. Aktualisht, i burgosuri pritet të dënohet me 19 vjet burgim për shkak të grabitjes, armëmbajtjes pa leje dhe shumë veprave të tjera që rëndojnë mbi të.



Pas Lëvizjes Vetëvendosje, edhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe Partia Socialdemokrate kanë deponuar nënshkrimet e deputetëve për shpërndarjen e Kuvendit të Kosovës

Analistët paralajmërojnë se mund të mos shpërndahet Kuvendi më 22 gusht

Subjektet politike parlamentare kanë filluar deponimin e nënshkrimeve të deputetëve të tyre për shpërndarjen e Kuvendit të Kosovës më 22 gusht, por njohësit e rrethanave politike kanë paralajmëruar mundësinë e formimit të një qeverie pa shkuar në zgjedhje të parakohshme. Ndonëse të gjitha subjektet politike kanë shprehur vullnetin e tyre për zgjedhje, analisti Vigan Qorrolli ka bërë me dije se nëse më 22 gusht 80 deputetë nuk votojnë për shpërndarjen e Kuvendit, atëherë presidentit i hapet mundësia ta provojë formimin e qeverisë së re pa shkuar vendi në zgjedhje

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHINË, 8 GUSHT - Pas pajtimit që seanca për shpërndarjen e Kuvendit të mbahet më 22 gusht, partitë politike kanë filluar t'i deponojnë nënshkrimet e deputetëve të tyre për shpërndarjen e Legjislaturës së VI. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Partia Socialdemokrate (PSD) kanë treguar se deponimi i këtyre nënshkrimeve tregon për vullnetin e tyre për zgjedhje të parakohshme.

Shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Ahmet Isufi, ka bërë me dije se ka deponuar nënshkrimet e deputetëve të kësaj partie për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme më 22 gusht 2019, ku në rend dite do të jenë votimi i IPA-s

2018 dhe shpërndarja e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Ai ka thënë se Aleanca është gati për procesin zgjedhor dhe, sipas tij, e bindur për fitore. "Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës është gati për procesin zgjedhor që na pret, e bindur për fitore për shkak të qeverisjes dinamike dhe vendimeve të mëdha që janë marrë nga qeveria Haradinaj dhe vendimet e mëdha që pritet të merren në të ardhmen. Tani më e fuqishme se kurrë Aleanca është e gatshme me ofertën më të mirë të forcimit të lidhjes së qytetarit me shtetin dhe me vizion të qartë për të ardhmen euroatlantike", ka thënë Isufi.

Edhe shefi i grupit parlamentar i PSD-së, Dardan Sejdiu, ka treguar se edhe deputetët e kësaj partie kanë deponuar nënshkrimet për

shpërndarjen e Kuvendit. Ai ka theksuar se zgjedhjet e reja janë rrugë për të ecur përpara. "Sot dorëzuar nënshkrimet për seancën e datës 22 gusht, seancë kjo e thirrur për shpërndarjen e kësaj legjislature. Zgjedhjet janë rruga përpara dhe në zgjedhje zgjidhja që duhet ofruar është programore.

Partia Socialdemokrate është e gatshme dhe tash më e shtrirë gjithandej Kosovës, programin me masa e politika konkrete gati, ndërsa ekipin të etshëm për përballje demokratike dhe përmbajtjesore. Rruga përpara është e qartë, një ekip me program, me guxim dhe dije", ka deklaruar Sejdiu.

Ditë më parë këtë veprim e ka bërë edhe Lëvizja Vetëvendosje. "Konform pajtimit në mbledhjen

e djeshme të kryesisë së Kuvendit, grupi parlamentar i Vetëvendosjes ka deponuar në Kuvend nënshkrimet e 19 deputetëve për thirrjen e seancës për shpërndarjen e Legjislaturës VI të Kuvendit", ka njoftuar Zyra për Informim e Kuvendit të Kosovës. Por, njohësit e rrethanave politike në vend kanë paralajmëruar se mund të mos ndodhë shpërndarja e Kuvendit më 22 gusht.

Analisti politik Vigan Qorrolli ka shkruar në profilin e vet në "Facebook" se nëse kjo nuk ndodh, atëherë hapet mundësia e formimit të një qeverie të re pa shkuar në zgjedhje. "Në rast se më 22 gusht së paku 80 deputetë nuk votojnë 'pro' shpërndarjes së kësaj legjislature, në rast të votimit negativ (të pasuksesshëm) me 80 vota 'për', deputetët i japin shkas presidentit të vendit dhe shefave të tyre të hyjnë në pazar për formimin e një qeverie të re pa zgjedhje. Kujt i konvenon 'arnimi' dhe kujt i konvenon 'legjitimimi' me zgjedhje të reja, kjo pritet të shihet sot dy javë. Drita e vetëdijes së re duhet të ndodhë dhe Kuvendi të shpërndahet. Deputetët asgjë

tjetër më të mirë nuk kanë për të bërë sesa kjo, të enjten e 22 gushtit", ka shkruar Qorrolli.

Të hënën kryesia e Kuvendit, me pajtimin e të gjitha subjekteve politike parlamentare, ka vendosur që seanca për shpërndarjen e Kuvendit të mbahet më 22 gusht në mënyrë që t'i hapet rruga presidentit të vendit ta caktojë datën për mbajtjen e zgjedhjeve të reja. Mbledhjen e kryesisë së Kuvendit për shpërndarjen e kësaj legjislature e kishte kërkuar kryeparlamentari Kadri Veseli pasi presidenti Hashim Thaçi i kishte kërkuar shefit të koalicionit PAN që ta propozojë kandidatin tjetër për kryeministër. Në përgjigjen e tij për presidentin, Veseli kishte thënë se pas dorëheqjes së kryeministri Ramush Haradinaj ky koalicion nuk ka kandidat tjetër për kryeministër.

Nëse Kuvendi shpërndahet më 22 gusht, sipas Kushtetutës, zgjedhjet e parakohshme nuk mund të mbahen më herët se tridhjetë (30) ditë dhe me vonë se dyzetë e pesë (45) ditë pas shpërndarjes. Në bazë të kësaj, zgjedhjet e parakohshme pritet të mbahen në fund të muajit shtator apo në fillim të muajit tetor.



Kosovës i shtohen edhe tri parti të reja

PRISHINË, 8 GUSHT (ER) - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka marrë vendim të enjten që ta miratojë kërkesën e tri partive politike për regjistrim. Për

iniciativën politike Partia Balliste, Partinë Euroatlantike të Kosovës e udhëhequr nga deputeti Milaim Zeka dhe Partinë Demokratike të Diasporës.

"Konstatohet se me 8 vota për është regjistruar subjekti politik Partia Balliste me numër rendor 54. Me 9 vota për është regjistruar Partia Euroatlantike e Kosovës

(PEK), me numër rendor 55. Me 9 vota për është regjistruar Partia Demokratike e Diasporës, me numër rendor 56", ka thënë kryetarja e KQZ-së, Valdete Daka.



Flet për "Epokën e re", Islam Pacolli

AKR-ja nuk e ka problem



- Për mendimin tim, Aleanca Kosova e Re (AKR) duhet të garojë e vetme në zgjedhje

Deputeti i Aleancës Kosova e Re (AKR), Islam Pacolli, ka bërë me dije se kjo parti është e përgatitur për zgjedhje të reja kurdo që ato mbahen. Ai ka thënë se AKR-ja nuk do ta ketë problem kalimin e pragut zgjedhor. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Pacolli ka deklaruar se ende nuk është vendosur nëse kjo parti do të garojë e vetme apo në koalicione. Ai ka theksuar se AKR-ja nuk e injoron dhe nuk ka vija të kuqe për askënd. Megjithatë, sipas Islam Pacollit, AKR-ja në këto zgjedhje do të duhej të garonte e vetme. Ai ka shprehur optimizëm se puna e ndershme e AKR-së do të vlerësohet nga qytetarët

kalimin e pragut zgjedhor



Pacolli ka treguar se ende nuk është vendosur nëse kjo parti do të garojë e vetme apo në koalicion.

Ai ka thënë se AKR-ja nuk e injoron dhe nuk ka vija të kuqe për askënd. Megjithatë, sipas Pacollit, AKR-ja në këto zgjedhje do të duhej të garonte e vetme. Madje, sipas tij, AKR-ja nuk do ta ketë problem kalimin e pragut zgjedhor. "Pëlqimi im ka qenë dhe mbetet që AKR-ja të garojë e vetme në zgjedhje, mirëpo kjo çështje nuk varet nga unë, por nga organet e partisë. AKR-ja nuk e ka problem kalimin e pragut zgjedhor", ka deklaruar Pacolli, duke shtuar se kjo parti do të jetë sërish përcaktuese për formimin e qeverisë së re. "AKR-ja ka punuar dhe do të vazhdojë të punojë për të mirën e qytetarëve", ka thënë ai. Duke folur për qeverisjen e deritanishme, ai ka thënë se AKR-ja ka punuar ndershëm dhe se i ka realizuar detyrat më mirë se secila parti tjetër. "Dëshira për të bërë shumë më shumë është e madhe por, megjithatë, çdo punë që kemi bërë mendoj se e kemi realizuar më mirë se çdo parti tjetër", ka deklaruar Pacolli.

"Epoka e re": Z. Pacolli, si i komentoni zhvillimet në skenën politike, përkatësisht caktimin e datës së shpërndarjes së Kuvendit, pastaj shkuarjen në zgjedhje të parakohshme?

Pacolli: Çfarëdo që të ndodhë ky është vendi ynë dhe duhet ta japim kontributin tonë. Shpeshherë gjërat nuk shkojnë në drejtimin më të mirë, madje nganjëherë nuk i bëjnë mirë as vendit por, ndoshta, kësaj radhe është mirë të shkohet në zgjedhje të reja.

"Epoka e re": Mendoni se ka qenë koha e duhur për dorëheqjen e kryeministrit dhe për zgjedhje?

Pacolli: Nuk dua t'i komentoj veprimet e të tjerëve por, për mendimin tim, Kosova duhet të përqendrohet në përmirësimin e funksionimit të shtetit sa i përket respektimit të ligjit dhe llogaridhënies. Çdo pushtetar duhet të jetë përgjegjës ndaj qytetarëve dhe ndaj ligjit.

"Epoka e re": A është AKR-ja e konsoliduar dhe e përgatitur për zgjedhje në rast se më 22 gusht shpërndahet Kuvendi?

Pacolli: AKR-ja nuk e ka asnjë problem dhe është e përgatitur

për zgjedhje. Kurdo që shpallen zgjedhjet ne jemi të gatshëm dhe qytetarëve do t'u ofrojmë njerëz adekuatë, pastaj varet prej qytetarëve nëse duan një qeverisje më të mirë apo jo.

"Epoka e re": Aktualisht shumica e subjekteve politike kanë shprehur pëlqimet e tyre lidhur me koalicionet parazgjedhore. AKR-ja ka vendosur se me kë do të bëjë koalicion apo do të garojë e vetme?

Pacolli: Jo, nuk kemi marrë ndonjë vendim të tillë në kryesi të partisë. Por, ndoshta, gjatë këtyre ditëve në strukturat e partisë do të mund të bisedohet edhe për këtë çështje.

"Epoka e re": Ju personalisht mendoni se AKR-ja do të duhej të garojë e vetme apo si koalicion?

Pacolli: Pëlqimi im ka qenë dhe mbetet që AKR-ja të garojë e vetme në zgjedhje, mirëpo kjo çështje nuk varet nga unë, por nga organet e partisë.

"Epoka e re": Në rast se AKR-ja do të garojë e vetme ashtu siç ju pëlqeni, a besoni se ka kapacitet për ta kaluar pragun zgjedhor?

Pacolli: AKR-ja nuk e ka problem kalimin e pragut zgjedhor.

"Epoka e re": Mbi çfarë baze i mbështetni këto pritje?

Pacolli: AKR-ja ka qeverisur ndershëm, nuk ka afëra korruptive dhe nuk është parti shantazhuese. Kështu që votuesit e AKR-së duhet të ndihen krenarë meqë AKR-ja nuk e ka keqpërdorur buxhetin e shtetit, por ka punuar sinqerisht. Kemi pasur qasje të mirë në qeverisje, por fuqia jonë politike ka qenë më e zbehtë meqë nuk kemi pasur shumë deputetë.

"Epoka e re": Ndonëse ju preferoni të garoni vetëm, zëvendëskryetari i AKR-së, Agim Bahtiri, ka bërë me dije se pëlqen një koalicion parazgjedhor me LV-në. Sa ka gjasa të ndodhë një koalicion i tillë?

Pacolli: Për këtë do të vendosin organet e partisë. Kurse sa i përket mendimit tim, AKR-ja duhet të garojë e vetme.

"Epoka e re": Edhe pse AKR-ja ka pasur pak deputetë, ka marrë shumë hise në pushtet. Sa keni arritur t'i realizoni objektivat?

Pacolli: Dëshira për të bërë shumë më shumë është e madhe por, megjithatë, çdo punë që kemi bërë mendoj se e kemi realizuar më mirë se çdo parti tjetër.

"Epoka e re": Prisni që kjo qeverisje do t'ju përkthehet në votë gjatë këtij procesi zgjedhor?

Pacolli: Puna e ndershme e AKR-së besoj se do të vlerësohet nga qytetarët. Unë kam qenë një ndër deputetët më të zëshëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe çdoherë i kam trajtuar çështjet që kanë qenë në interes të qytetarëve. Asnjëherë në Kuvend nuk kemi ngritur zërin për çështje personale apo partiake. Ajo që më ka penguar shumë dhe vazhdon të pengojë shumë është se shumica e politikanëve thirren në interesat e qytetarëve, por punojnë për interesat personale dhe partiake. Edhe pse kam pasur vështirësi, sepse kam qenë deputet pa grup, megjithatë çdo çështje e kam trajtuar në mënyrë adekuate. Nuk jam ihtar i atyre që e zhvatin shtetin, sepse buxheti nuk është i pushtetarëve, por i taksapaguesve. Jam një ndër deputetët që asnjëherë nuk ka udhëtuar me buxhet të shtetit. Është vështirë të realizohet programi nëse nuk ke fuqi të mjaftueshme politike. Ka pasur progres gjatë kësaj qeverisje në disa aspekte. Rajoni i Gollakut ka qenë i anashkaluar nga qeveritë e kaluara dhe, përveç AKR-së, të tjerat nuk kanë bërë asgjë sidomos për rrugët në atë pjesë. Gollaku nuk e ka asnjë metër autostradë, prandaj qeveria e ardhshme duhet të bëjë më shumë në këtë drejtim.

"Epoka e re": Edhe pas këtyre zgjedhjeve AKR-ja do të jetë përcaktuese për formimin e institucioneve?

Pacolli: AKR-ja nuk e injoron dhe nuk ka vija të kuqe për askënd. Mendoj se AKR-ja do të jetë sërish përcaktuese për formimin e qeverisë së re. AKR-ja ka punuar dhe do të vazhdojë të punojë për të mirën e qytetarëve.

"Epoka e re": Z. Pacolli, kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, si dhe deputeti Labinot Tahiri në vazhdimësi kanë dhënë deklarime të ndryshme sa i përket qëndrimit në AKR. Ka rrezik që në prag të këtyre zgjedhjeve ata ta braktisin partinë?

Pacolli: Ata ende janë në AKR. Në AKR zyrtarët kanë dhënë deklarata të ndryshme dhe kjo është e mirë si dhe është tregues se në partinë tonë ka demokraci dhe liri të shprehjes. Mendoj se treguesi më i mirë i demokracisë është AKR-ja. Bahtiri e Tahiri janë dy figura të rëndësishme që kanë dhënë dhe vazhdojnë ta japin kontributin e tyre në AKR.

EPOKA E RE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 8 GUSHT - Deputeti i Aleancës Kosova e Re (AKR), Islam Pacolli, ka mirëpritur caktimin e datës për shpërndarjen e Kuvendit si dhe mundësinë e shkuarjes në zgjedhje të parakohshme. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se Kosova duhet të përqendrohet në përmirësimin e funksionimit të shtetit. "Çfarëdo që të ndodhë, ky është vendi ynë dhe duhet ta japim kontributin tonë. Shpeshherë gjërat nuk

shkojnë në drejtimin më të mirë, madje nganjëherë nuk i bëjnë mirë as vendit por, ndoshta, kësaj radhe është mirë të shkohet në zgjedhje të reja", është shprehur Pacolli, duke shtuar se AKR-ja është e përgatitur për zgjedhjet e reja. "AKR-ja nuk e ka asnjë problem dhe është e përgatitur për zgjedhje. Kurdo që shpallen zgjedhjet ne jemi të gatshëm dhe qytetarëve do t'u të ofrojmë njerëz adekuatë. Pastaj varet prej qytetarëve nëse duan një qeverisje më të mirë apo jo", ka theksuar ai.

Dita e parë e Kurban Bajramit, të dielën

PRISHTINË, 8 GUSHT (ER) - Kryesia e Bashkësisë Islame e Kosovës ka njoftuar besimtarët dhe opinionin e gjerë, se dita e parë e festës së Kurban Bajramit është ditën e diele, më 11 gusht 2019.

Manifestimi qendror për territorin e Kosovës, kushtuar festës së Kurban Bajramit, mbahet në Xhaminë e Madhe në Prishtinë.

Manifestimi fillon në orën 4:55, me faljen e namazit të

sabahut, pas të cilit do të jetë ligjërata tematike kushtuar kësaj feste, të cilën do ta mbajë dr. Sadat Islami - Ligjërues në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë.

Namazi i Kurban Bajramit falet në orën 06:15 të cilit do t'i prijë Jakup ef. Çunaku, drejtor i Medresesë "Alaudin" në Prishtinë, ndërsa Hytben - mesazhin e Kurban Bajramit do ta mbajë zëvendëskryetari i Kryesisë së Bashkësisë Islame

të Kosovës, Reshat ef. Mexhidi. Me rastin e festës së Kurban Bajramit, ditën e parë, më 11 gusht 2019, kryesia e BIK-ut si tradicionalisht organizon pritje përurimi në selinë e kryesisë nga ora 9:00-12:00.

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës të gjithë besimtarëve dhe opinionit të gjerë ua uron festën e Kurban Bajramit, duke e lutur Zotin që të na pranojë haxhin, kurbanin, lutjet dhe ibadetet tona.



Mustafa: LDK-ja nuk ka shumë disponim për koalicione parazgjedhore



PRISHTINË, 8 GUSHT (ER) - Lideri i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, ka pritur të enjten në takim ambasadorin e Italisë në Kosovë, Piero Sardi.

Me këtë rast, ambasadori Sardi e ka uruar kryetarin Mustafa për rizgjedhjen në krye të LDK-së duke thënë se Kuvendi Zgjedhor ishte një takim i rëndësishëm në udhëtimin demokratik të kësaj partie dhe vendit.

Mustafa e ka njoftuar ambasadorin Sardi për përgatitjet e LDK-së për zgjedhjet e përgjithshme, në të cilat, siç ka thënë ai, "LDK-ja parapëlqen që të gjitha partitë të shkojnë të vetme. LDK-ja do t'i përcjellë veprimet e partive të tjera dhe do të ndërmarrë veprime në

përputhje me rrethanat politike. LDK-ja nuk ka shumë disponim për koalicione parazgjedhore por, mbi të gjitha, po punojmë t'i fitojmë zgjedhjet në mënyrë që partitë që sot janë në opozitë ta formojnë qeverinë e re të Kosovës me një shumicë të qëndrueshme që u bënë ballë temave të mëdha me të cilat po ballafaqohet vendi". Në këtë takim është theksuar se në qeverinë e re LDK-ja do të përqendrohet në zhvillimin ekonomik, përkrahjen e sektorit privat, avancimin e arsimit dhe shëndetësisë, sundimin e rendit dhe ligjit, luftimin e korrupsionit si dhe integrimet euroatlantike me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve të Kosovës.

Universiteti 'Isa Boletini' përfiton disa projekte në kuadër të programit Erasmus+

MITROVICË, 8 GUSHT (ER) - Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" (UMIB) ka përfituar disa projekte në kuadër të programit Erasmus+. Rektori Alush Musaj ka thënë se këto projekte janë shumë të rëndësishme për studentët, stafin akademik dhe të ardhmen e UMIB-it.

Në partneritet me institucionet vendore dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë, UMIB ka fituar projektin "Përmirësimi i kulturës së kërkimit në arsimin e lartë në Kosovë", në vlerë rreth një milion euro. Ky projekt do të zgjasë rreth tre vjet dhe është një mundësi e mirë për shkëmbimin e përvojave ndërmjet universiteteve

partnere dhe ngritjes së kulturës së kërkimit në institucionet e arsimit të lartë në vend dhe më gjerë.

Projekti tjetër që është zgjedhur për financim në kuadër të programit Erasmus+ ka të bëjë me bashkëpunimin ndërkombëtar dhe përmirësimin e menaxhimit të projekteve. Në këtë projekt të zgjedhur për financim UMIB është partner.

Në ndërkohë si partner, Fakulteti Edukimit ka fituar projektin "Towards a quality oriented initial teacher education in Kosovo".

Ky projekt vlerësohet i një rëndësie të veçantë për Fakultetin e Edukimit, pasi kon-



tribuon drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë së programeve që

ofrohen, cilësisë së mësimdhënies dhe cilësisë së përgatitjes

së studentëve si mësimdhënës të ardhshëm.

Fillojnë punimet për kanalizimin e fshatit Burim në Malishevë

MALISHEVË, 8 GUSHT (ER) - Nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, ka inspektuar të enjten nga afër punimet e filluara në kanalizimin prej 1 000 metrave në fshatin Burim. "Qeveria komunale është në angazhim me kapacitete të plota për

realizimin e planifikimeve sipas dinamikës së paraparë, në infrastrukturën e kanalizimeve, rrugëve me shtrim të asfaltit, trotuareve dhe ndriçimeve", ka thënë Berisha. Ai para fshatarëve të Burimit ka thënë se projektet do të vazhdojnë edhe në infra-

strukturën shkollore. Kurse përgjegjësi komunal për punimet e kanalizimit në fshatin Burim, Januz Krasniqi, ka kërkuar nga kompania që të respektohet kontrata dhe punimet të kryhen sipas standardeve të parapara në kontratë.



Ministri i Mbrojtjes: Tranzicioni i FSK-së do të jetë transparent

Ministri i Mbrojtjes, Rrustem Berisha, gjatë takimit me shefin e Operacioneve dhe Misioneve të NATO-s, Michel Soula dhe drejtorin e ekipit këshillues dhe ndërlidhës të NATO-s (NALT), gjeneralbrigade Michael Oberneyer, ka rikonfirmuar se tranzicioni i FSK-së do të jetë transparent dhe i bashkërenduar, që garanton zhvillimin e një force të besueshme, gjithëpërfshirëse dhe në të mirë të të gjithë qytetarëve të Kosovës si një forcë që do të kontribuojë për paqe dhe siguri në rajon dhe më gjerë



do të kontribuojë për paqe dhe siguri në rajon dhe më gjerë. Ministri Berisha ka theksuar se deklaratat e pamatura të zyrtarëve të lartë të Serbisë nuk i kontribuojnë ruajtjes së paqes dhe stabilitetit në rajon pasi, sipas tij, mund ta nxisin rritjen e tensioneve ndëretnike. Ai ka shtuar se Kosova është e përkushtuar ndaj vlerave euroatlantike dhe se FSK-ja është e gatshme që edhe me kapacitetet e tanishme t'i përkrahë aleatët kurdo që kërkohet prej saj. Shefi i Operacioneve dhe Misioneve të NATO-s, Michel

Soula, ka përgëzuar ministrin Berisha për transparencën ndaj partnerëve, punën profesionale dhe bashkëpunimin e mirë me NALT-in dhe KFOR-in. Ai ka theksuar se NATO-ja ka një përkushtim afatgjatë ndaj Kosovës dhe se përkrahja përmes NALT-it për FSK-në do të vazhdojë edhe më tej. Soula e njoftoi ministrin edhe për diskutimet e nivelit të lartë në NATO rreth bashkëpunimit NATO-FSK në të ardhmen. Ministri Berisha ka shprehur bindjen se diskutimet brenda NATO-s rreth marrëdhënieve me

FSK-në do të avancojnë dhe se aleatët do të marrin vendime që u shërbejnë thellimit të raporteve tona, besimit të ndërsjellë dhe stabilitetit në rajon.

Edhe në takimin e gjeneral Ramës me zyrtarin e lartë të NATO-s, Soula, u bisedua për bashkëpunimin e mirë ndërmjet NATO-s dhe FSK-së, nëpërmjet NALT-it dhe këshilltarëve të NATO-s, si dhe për përkushtimin e vazhdueshëm që ka Kosova për të qenë shtet anëtar i NATO-s si dhe shtet i integruar në Bashkimin Evropian.

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 8 GUSHT - Ministri i Mbrojtjes, Rrustem Berisha, dhe komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama, kanë pritur të enjten në takime të ndara Michel Soula, shef i Operacioneve dhe Misioneve të NATO-s, i shoqëruar nga drejtori i Ekipit këshillues dhe ndërlidhës i NATO-s (NALT), gjeneralbrigade Michael Oberneyer dhe këshilltar nga ekipi i NALT-it. Së pari ministri Berisha e ka falënderuar shefin e Operacioneve dhe Misioneve të NATO-s për angazhimin e

NATO-s për paqe dhe siguri në Kosovë, për bashkëpunimin e shkëlqyer me KFOR-in dhe Ekipin e NALT-it, si dhe për angazhimin dhe interesimin e NATO-s për Kosovën, sigurinë dhe prosperitetin e saj.

Më tej, ministri i Mbrojtjes e ka njoftuar përfaqësuesin e NATO-s lidhur me procesin e tranzicionit, kryesisht angazhimin me prioritet për zbatimin e planit gjithëpërfshirës të tranzicionit të FSK-së, duke rikonfirmuar se ky proces do të jetë transparent dhe i bashkërenduar, që garanton zhvillimin e një force të besueshme, gjithëpërfshirëse dhe në të mirë të të gjithë qytetarëve të Kosovës, si një forcë që



Kollçaku: Kjo qeveri dështoi ta bëjë fondin e sigurimeve shëndetësore

EPOKA E RE

Faton DERMAKU

PRISHTINË, 8 GUSHT - Nënkryetarja e Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Fatmire Kollçaku, ka thënë se bilanci i punës së një qeverie bëhet nga këndvështrimi i qytetarëve nëse ka sjellë ndryshim cilësor në mirëqenien e tyre. Ajo ka thënë se padrejtësia te punëtorët tanë dhe te pacientët ka mbërritur kulmin. "Premtuan se do ta rrisnin pagën minimale, dështuan. Premtuan se do të bënin ligjin e ri të punës, sipas tyre, më të mirë e më të përshtatshëm. As nuk e hartuan të tillë e as nuk mbërritën ta finalizonin. Premtuan se do të rrisnin punësimin me programet e Ministrisë së Punës, dështuan", ka deklaruar Kollçaku në një konferencë për medie. Sipas saj, në vitin e

kaluar në Kosovë janë 17 mijë vende pune më pak. "Premtuan se do të bënin ligjin e veçantë për pushimin e lehonisë, dështuan. E hoqën atë edhe nga projekti i Ligjit të punës, gjë e papranueshme. Premtuan se do ta rrisnin pagën minimale, dështuan. Askund nuk duket në horizont puna dhe vendimmarrja e Këshillit Social Ekonomik, e as dëshmia e vullnetit politik në këtë drejtim. Premtuan se do të marrin masa për sigurinë dhe shëndetin në punë, dështuan. Inspektorati i Punës është shumë larg standardeve për mbrojtjen e punëtorëve. Nuk ka ditë që nuk njoftohet për lëndimin apo edhe për humbjen e jetës së dikujt. Premtuan reformë të sistemit pensional, dështuan plotësisht. Asnjë lëvizje në atë drejtim. Premtuan buxhetimin e qëndrueshëm të



strehimoreve për gratë, dështuan. Në fakt, mashtruan. Premtuan se do t'i buxhetonin shtesat për fëmijët, dështuan. Asnjë cent nuk ndan për këtë vit e për vitet në vijim", ka theksuar Kollçaku.

Më tutje, ajo ka thënë se punëtorët në industrinë e shërbimeve dhe punëtorët në ndërtimtari paguhen

shumë pak e punojnë me orare të zgjatura, pa pushime të plota vjetore, pa sigurime shëndetësore, pa dy ditë në javë pushim dhe pa kontratë.

Nënkryetarja Kollçaku ka thënë se Ministria e Shëndetësisë është një prej dështimeve më të mëdha të ish-qeverisë. "Së bashku me

Ministrinë e Punës ata janë përgjegjës drejtpërdrejt për cilësinë e jetës në këtë vend. Roli i ministrisë është drejtimi dhe hartimi i politikave që adresojnë krizën në shëndetësi. Por, a e dini sa projektligje të reja i ka sjellë gjatë dy vetëve të PANQeverisë ish-ministri i Shëndetësisë? Një për të mos thënë zero, sepse Ligji për transfuzionin e gjakut ishte nga mandati i kaluar dhe ishte i gatshëm. Thanë se do ta bëjnë fondin e sigurimeve shëndetësore para se të bëhen protokollat e sistemeve informative. Dështuan. Ngase as nuk bëhet dot ashtu, e as nuk dinin çka po deklarorin. Sot ne jemi pa sigurime shëndetësore. 20 vjet pas çlirimit", ka theksuar Kollçaku. Sipas saj, lajmi i vetëm i mirë në këto dy sektorë është se qeveria u rrëzua.

Ambasadorja e Holandës në Kosovë vlerëson punën e BQK-së

PRISHTINË, 8 GUSHT (ER) - Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovë, Fehmi Mehmeti, ka pritur të enjten në takim ambasadorën e Holandës në Kosovë, Gerrie Willems. Duke shprehur mirënjohjen e lartë për vizitën në BQK, guvernatori Mehmeti ka njoftuar ambasadorën Willems për zhvillimet ekonomike dhe lidhur me zhvillimet në sektorin financiar të vendit, në veçanti sektorin bankar, i cili vazhdon të performojë mirë, duke nënvizuar rritjen e aktivitetit të këtij sektori në mbështetje të zhvillimit ekonomik të vendit dhe shkallën e lartë të qëndrueshmërisë që gëzon ky sektor. Gjithashtu, guvernatori ka njoftuar ambasadorën Willems

për zhvillimet e fundit edhe në sektorët e tjerë financiarë, si sektorin e sigurimeve, fondeve pensionale, të institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare.

Guvernatori Mehmeti ka falënderuar ambasadorën për vizitën dhe përkrahjen e shtetit holandez për mbështetjen e Republikës së Kosovës për realizimin e projekteve të ndryshme.

Ndërsa ambasadorja e Holandës në Kosovë, Gerrie Willems ka vlerësuar lart punën e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe zhvillimet në sistemin financiar si dhe ka shprehur gatishmërinë e saj për përkrahje të mëtejme të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.



Qytetarët që kanë punuar në Zvicër përfitimet e pensionit mund t'i marrin pas 1 shtatorit



PRISHTINË, 8 GUSHT (ER) - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka njoftuar qytetarët me vendbanim në Kosovë dhe bashkatdhetarët me vendbanim në Zvicër, se marrëveshja për sigurime sociale e lidhur në mes të Republikës së Kosovës dhe Konfederatës së Zvicrës hyn në fuqi nga data 1 shtator 2019. Sipas kësaj ministrie, kërkesat mund të paraqiten nga data 1 shtator 2019, ndërkaq përfitimet mund të merren pas datës 1 shtator 2019. "Nga 1 shtatori 2019 të gjithë ju që keni kontribuar në shtetin e Zvicrës mund të filloni t'i paraqisni kërkesat për përfitim

të pensioneve dhe beneficioneve në bazë të marrëveshjes për sigurime sociale mes dy shteteve tona. Kjo marrëveshje të cilën e nënshkruam vitin e kaluar hyn në fuqi nga 1 shtatori, duke ua dhënë mundësinë qytetarëve që të gëzojnë një të drejtë e cila u ishte mohuar për një kohë të gjatë. Urime për të gjithë qytetarët e Kosovës që kanë derdhur djersën dhe kontribuar për familjet e tyre për aq vite. Falënderoj shtetin e Zvicrës për gatishmërinë për t'i dhënë zgjidhje çështjes së sigurimeve sociale mes dy shteteve tona", ka shkruar ministri Reçica në llogarinë e vet në "Facebook".

Shala: Ta shfrytëzojmë sektorin e teknologjisë për ta rritur punësimin

PRISHTINË, 8 GUSHT (ER) - Ministri në detyrë i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Muzafer Shala, ka vizituar të enjten komunën e Ferizajt, ku është takuar me kryetarin e kësaj komune, Agim Aliu. Gjatë këtij takimi ministri Shala dhe kryetari Aliu kanë biseduar për rritjen e punësimit nëpërmjet fushës së teknologjisë informative duke shfrytëzuar kapacitetet njerëzore.

Ministri në detyrë, Shala, ka thënë se ministria të cilën e drejton do ta ketë fokus përkrahjen edhe fuqizimin e bizneseve që merren me teknologji, inovacion dhe ndërmarrësi. "Si Ministri e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë synojmë që nëpërmjet shfrytëzimit të kapaciteteve njerëzore ta rrisim punësimin dhe zhvillimin ekonomik. Po

ashtu, do t'i përkrahim për t'u zhvilluar ndërmarrjet inovative duke angazhuar sa më shumë të rinj dhe gra në biznese fillestare", ka thënë Shala. Ai ka thënë se duhen shfrytëzuar në formën dhe mënyrën e duhur kapacitetet dhe mundësitë të cilat ofrohen në fushën e teknologjisë, pasi Kosova mund të gjenerojë deri në 50 mijë vende pune vetëm në fushën e IT-së, brenda dhjetë vjetëve të ardhshme.

Ministri në detyrë i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Muzafer Shala, ka thënë se kjo është dekada e teknologjisë informative dhe eksportit të shërbimeve në gjithë botën, prandaj edhe Kosova me një popullatë të re duhet t'i shfrytëzojë këto mundësi që ofrohen sot.



Shala: Maqedonia t'i heqë barrierat ndaj produkteve të Kosovës, përndryshe do të ketë reciprocitet

Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, i ka dërguar letër ministrit të Ekonomisë të Maqedonisë së Veriut, Kreshnik Bekteshi, nga i cili ka kërkuar që sa më shpejt të largohen barrierat të cilat i ka vendosur ky shtet ndaj produkteve të Kosovës lidhur me ndalimin e eksportit të rasatit të peshkut nga Republika e Kosovës në drejtim të tregut të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Përndryshe, Shala ka paralajmëruar masa reciprociteti për të gjitha prodhimet e Maqedonisë së Veriut që eksportohen në Kosovë



**EPOKA
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 8 GUSHT - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, i ka dërguar letër ministrit të Ekonomisë të Maqedonisë së Veriut, Kreshnik Bekteshi, nga i cili ka kërkuar që sa më shpejt të largohen barrierat të cilat i ka vendosur ky shtet ndaj produkteve të Kosovës. Në këtë letër ministri Shala ka adresuar shqetësimin lidhur me ndalimin e eksportit të rasatit të peshkut nga Republika e Kosovës në drejtim të tregut të Republikës së Maqedonisë së Veriut. "Më lejoni që përmes kësaj shkrese në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe komunitetit të biznesit ta adresoj shqetësimin lidhur me ndalimin e eksportit të rasatit të peshkut nga Republika e

Kosovës në drejtim të tregut të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Vendimi ka hyrë në fuqi nga data 01.06.2019, me të cilin ndalohet importi i peshkut të gjallë që dedikohet për rritje ose mbushjen e hurdhave me peshq të vegjël me prejardhje nga Republika e Kosovës. Për të tepër, është vendosur edhe një taksë prej afër 700 eurosh për çdo hyrje të kamionëve të peshkut në Maqedoninë e Veriut", është thënë në këtë letër.

Ministri Shala ka njoftuar ministrin e Ekonomisë së Maqedonisë së Veriut se ky shqetësim është ngritur në nivel teknik nga zyrtarët përgjegjës dhe fillimisht çështja është adresuar te Komiteti Nacional për Lehtësimin e Tregtisë së Maqedonisë së Veriut më 26 qershor 2019, pas-taj në takimin e Pikave të

Kontaktit të CEFTA-s në Vlorë më 27 qershor, në data-bazën e CEFTA-s për raportim të barrierave tregtare më 1 korrik 2019 dhe në fund përmes disa shkëmbimeve të e-mailave në mes të zyrtarëve respektivë por, sipas tij, deri më tani nuk është gjetur një zgjidhje. Ministri Shala ka thënë se bashkëpunimi tregtar më së miri vërehet në rritjen e shkëmbimeve tregtare në mes të dy vendeve në vitet e fundit gjë,

sipas tij, dëshmon përkushtimin e institucioneve të Kosovës për shtimin e mëtejshëm të bashkëpunimit dypalësh. "Më lejoni ta theksoj rëndësinë e të bërit tregti pa barriera në mes të dy vendeve tona dhe obligimet që të dy vendet kanë ndërmarrë në kuadër të Marrëveshjes së CEFTA-s. Këto shkelje nga Maqedonia e Veriut për angazhimet e saj në CEFTA përbëjnë një shqetësim të madh për qeverinë time dhe ju

ftoj të gjeni një zgjidhje për këtë çështje sa më shpejt të jetë e mundur. Jemi në pritje nga autoritetet e Maqedonisë së Veriut që do t'i heqë këto barrierat tregtare, në të kundërtën do të jemi të detyruar të reagojmë. Si reagim do të jetë trajtimi i njëjtë i produkteve të Maqedonisë së Veriut që hyjnë në tregun e Republikës së Kosovës", ka thënë Endrit Shala, ministër i Tregtisë dhe Industrisë.

Zyrtarët e aeroportit thonë se kërkesat e punëtorëve janë joligjore

PRISHTINË, 8 GUSHT - Punëtorët e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari" kanë protestuar të enjten për një orë, duke kërkuar përmirësim të kushteve të punës. Protesta nuk ka ndikuar në orarin e fluturimeve, mirëpo Autoriteti i Aviacionit Civil (AAC) ka kërkuar të gjendet zgjidhje rreth kërkesave të punëtorëve. "Protesta e sotme e punëtorëve të aeroportit nuk ka pasur ndikim në operimet normale të aeroportit. Autoriteti i Aviacionit Civil iu bënë thirrje Sindikatës së Punëtorëve dhe organit menaxhues të ANP 'Adem Jashari', kompanisë LKIA sh. a., të zhvillojnë dialog social dhe të gjejnë zgjidhje të pranueshme për të dyja palët brenda kornizës ligjore, në mënyrë që ta



parandalojnë pengimin e operimeve të aeroportit", është thënë në komunikatën për media të këtij Autoriteti. Ndërsa zëdhënësja e Aeroportit

Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari", Valentina Gara, i ka konsideruar joligjore kërkesat e punëtorëve. "Të gjithë punonjësit e Aeroportit

Ndërkombëtar të Prishtinës janë subjekt i kontratës punonjëspunëdhënëse, kërkesat e tyre konsiderohen të pabazuara dhe joligjore, duke u bazuar në këtë

kontratë. Disa nga kërkesat e tyre janë të bazuara në kontratën kolektive. Me përgjegjësi të plotë themi se Aeroporti është duke i përmbushur 100 për qind obligimet ndaj punëtorëve. Sa i përket kontratës kolektive, ajo nuk është e vlefshme dhe ne nuk jemi subjekt i asaj kontrate, prandaj kërkesat e tyre konsiderohen joligjore pasi bazohen në kontratën kolektive", ka thënë Gara. Kontrata Kolektive në Kosovë është një marrëveshje e arritur në bazë të Ligjit të Punës dhe, si e tillë, ligjërisht rregullon të drejtat e punëtorëve në sektorin publik dhe privat. Kontrata Kolektive parasheh shujtën, shpenzimet e udhëtimit dhe pagën jubilarë çdo 10 vjet për punëtorët.

Filluan punimet në rrugën Rahovec-Hamoc-Fortesë

RAHOVEC, 8 GUSHT (ER) - Zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Rexhep Kadriu, të enjten mori pjesë në fillimin e punimeve të rrugës Rahovec-Hamoc-Fortesë, investim i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit. Zëvendësministri Rexhep Kadriu ka thënë e edhe ky investim dëshmon përkushtimin e qeverisë, në këtë rast të MIT-së

dhe ministrit Pal Lekaj, për ndërtimin e rrugëve që ndikojnë në zhvillimin ekonomik dhe lehtësimin e qarkullimit të qytetarëve anekënd vendit. Ai ka shtuar se MIT-ja po investon në tërë Kosovën pa dallim. Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka shprehur falënderimin për përkushtimin e MIT-së që kjo rrugë të ndërtohet, në mënyrë

që t'i shërbejë zhvillimit të komunës. Rruga Rahovec-Hamoc-Fortesë është e gjatë mbi 10 kilometra. Vlera e investimit nga MIT-ja është afër 1 milion euro dhe do të bëhet me tërë infrastrukturën përcjellëse, përfshirë edhe shtegun për ciklistë. Kjo rrugë u mundëson qarkullim më të lirë mbi 1 000 fermerëve të kësaj ane.



Banka Botërore zotohet ta mbështesë Gjilanin për sigurimin e ujit të pijshëm

GJILAN, 8 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët, ka pritur të enjten në takim pune drejtorin e Bankës Botërore për Kosovë dhe Maqedoninë Veriore, Marco Montovanelli. Në takim u bisedua për programet që Banka Botërore i ka në Gjilan në mbështetje për eficiencën e energjisë për disa objekte publike, programet në arsim dhe programet e tjera, ndërsa programi më i madh është ai për sigurimin e ujit të pijshëm. "Jam jashtëzakonisht i lumtur për

mbështetjen dhe besimin. Projekti kryesor është zgjidhja e problemit të ujit të pijshëm në periudhë afatgjatë, për të cilin Banka Botërore dhe qeveria po punojnë shumë. Banka Botërore është donator e madh në Kosovë tash e 20 vjet dhe tashmë është në fazën fizibilitetit dhe hulumtimin e nevojave sa i përket ujit të pijshëm, në nivel regjioni. Janë projekte të shtrenjta dhe sapo të kemi diçka konkrete do ta bëjmë publike shumë", ka thënë Haziri pas takimit. Drejtori i Bankës Botërore për

Kosovën dhe Maqedoninë Veriore, Marco Montovanelli, është zotuar për mbështetje për Gjilanin për sigurimin e ujit të pijshëm. "Biseduam për disa projekte konkrete të cilat mendojmë t'i përkrahim që lidhen me këtë regjion. Prioritet mbetet zgjidhja lidhur me menaxhimin e ujërave dhe menaxhimin e mjedisit, ndihma në bujqësi, eficiencë të energjisë. Këto janë cekur si prioritete të Bankës Botërore. Shpresojmë të krijojmë ndryshime në nivel lokal, e që do të ndikojnë pozitivisht në jetën e



qytetarëve. Nga ana e Bankës Botërore e kemi zotimin që do të përpiqemi dhe përkrahim

Gjilanin në këtë sfidë të menaxhimit të resurseve ujore", është shprehur Montovanelli.

Kryetari Begaj mbajti takim me mërgimtarët



MALISHEVË, 8 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka mbajtur të enjten një takim me mërgimtarët malishevas që punojnë në vende të ndryshme evropiane. Begaj u ka uruar mirëseardhje mërgimtarëve pranë familjeve të tyre, duke theksuar se ata janë ndër kontribuuesit e lirisë të cilën e gëzojmë sot të gjithë bashkë. "Komuna e Malishevës do t'i ketë dyert e hapura për ju që ta sillni kapitalin tuaj për investime dhe ta ndërtojme një të ardhme më të mirë për fëmijët. Malisheva shpreh gatishmërinë për të bashkëpunuar me ju në të gjitha sferat, në veçanti në sferën e zhvillimit ekonomik, kulturor, në turizëm dhe sport, pasi ka këto

resurse natyrore", ka thënë Begaj. Edhe kryesuesi i Kuvendit Komunal, Rrahim Morina, si dhe këshilltarët komunalë u shprehën mirëseardhje mërgimtarëve malishevas, por edhe kërkuan nga ta të investojnë në Malishevë dhe t'i sjellin përvojat ekonomike të vendeve ku punojnë. Mërgimtari Agim Paçarizi ka falënderuar kryetarin e Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, për takimin e organizuar dhe bashkëbisedimin, duke theksuar se mërgimtarët janë të gatshëm për të bashkëpunuar me institucionet në Kosovë. "Kështu që kërkoj nga ju si komunë dhe qeveria qendrore të ofrojnë lehtësira ligjore për investime", ka thënë Paçarizi.

Arrestohet një person i dyshuar për disa raste të vjedhjeve në kryeqytet

PRISHTINË, 8 GUSHT (ER) - Njësitë i hetimeve të Stacionit Policor Qendra në Prishtinë ka arrestuar një person të dyshuar për disa raste të vjedhjeve. Rastet kanë ndodhur në qytetin e Prishtinës, në lokacione dhe periudha të

ndryshme kohore, kryesisht nëpër lokale (kafene), ku janë vjedhur çanta, portofola etj. Puna e hetuesve të Stacionit Policor Qendra lidhur me rastet në fjalë është finalizuar të mërkurën dhe ka rezultuar me arrestimin e



personit të dyshuar: G. B., mashkull, 16 vjeç, shtetas i Republikës së Kosovës (i dyshuar për njëmbëdhjetë vjedhje të raportuara deri tash në Stacionin Qendra në Prishtinë). Në koordinim me prokurorin kujdestar dhe

gjyqtarin e procedurës paraprake, aktualisht hetuesit po kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme hetimore e procedurale lidhur me rastet në fjalë, ndërkohë që personit të dyshuar i është shqiptuar masa e paraburgimit për 30 ditë.

Muharremaj të enjten takoi rreth 20 qytetarë, dëgjon hallet e tyre

Suharekë, 8 gusht - Kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, në vazhden e takimeve të rreg-

ullta me qytetarë, të enjten ka takuar mbi 20 qytetarë të moshave të ndryshme, me të cilët ka biseduar për të

gjitha problemet që i mendojnë ata. Kryetari Muharremaj ka dhënë përgjigje në të gjitha kërke-

sat e tyre dhe ka premtuar se brenda mundësive që ka komuna, kërkesat që kanë parashtruar do të zgjidhen.



Me rastin e njëvjetorit të vdekjes së Adem Demaçit, 26 korrik 2018 (14)

ADEM DEMAÇI, HERO I KOSOVËS DHE NDERI I KOMBIT

- Përshtypjet në "librin e zisë"



**Përgatiti: Selatin
NOVOSELLA**

Baca Adem Demaçi bëri Epokë me veprën e Tij! Duhet të reflektojnë liderët tanë dhe ta udhëheqin vendin me vendosmërinë e Bacës Adem! Lavdi e përjetshme simbolit të rezistencës shqiptare!

29 korrik 2018,
Kujtim Lushaj

Të duam apo s'të duam, hija Jote do të lëvizë natë e ditë nëpër rrugët e Prishtinës e të Tiranës!

29 korrik 2018,
Ahmet Beka

Sot më 29 korrik 2018 erdha për ngushëllime për Bacën Adem Demaçi, legjendën e patriotin e pavdekshëm të popullit shqiptar, i cili tërë jetën sakrifiko për çështjen kombëtare. Pusho i qetë i pavdekshmi dhe njeriu që lindë një herë në 500 vjet! Në respekt dhe kujtim të përhershëm!

29 korrik 2018,
Ismet Selmani

Pusho në paqe shpirti i Bacës Adem, i njeriut të pazëvendësueshëm të kombit shqiptar. Respekt jetës dhe veprës së Bacës Adem Demaçi, shokut të Azem Bagerit! Allahu i mëshiroftë në xhenet!

29 korrik 2018,
Idriz Selmani

Ju shpreh ngushëllime familjes Demaçi dhe gjithë shqiptarëve, me rastin e ndarjes nga jeta të Bacës Adem!

29 korrik 2018,
Xhevat Zhitia

Në çdo riorganizim të ri eventual për të sendërtuar amanetin e Bacës Adem, Ai do të jetë për ne inspirim për sakrificat të tjera për bashkimin kombëtar dhe për Shqipërinë natyrale!

29 korrik 2018,
Behrami, Prishtinë

Ngushëllime në emër të familjes Muzaçi. I pavdekshëm do jetë kujtimi për Bacën, Adem Demaçi!

29 korrik 2018,
Familja Muzaçi

Ngushëllime në emër të familjes Jusufi! Baca Adem do të jetojë me fjalët dhe veprat edhe tek gjeneratat e reja që vijnë!

29 korrik 2018,
Bekim Jusufi

Ngushëllimet më të sinqerta për familjen emblemë - Demaçi!

29 korrik 2018,
Familja Sahiti, Ferizaj

Të kujtojmë gjithmonë me krenari dhe dashuri njeriun e madh të kombit shqiptar - Bacën Adem! Adem Demaçi nuk ka vdekur as nuk vdes kurrë!

29 korrik 2018,
Familja Reçica, Ferizaj

Lavdi simbolit të rezistencës, të frymëzimit të gjithë shqiptarëve në rrugën e lirisë! Qoftë i përjetshëm kujtimi për njeriun - monument lirie!

29 korrik 2018,
Shaqir Cërvadiku, Naim Gashi, Fatmir Makolli

Ata të cilët deshën terrin, burgun e shqiptonjave, të mbajtën edhe Ty tri dekada, por Baca ynë ishte njeriu i cili kishte liri më shumë se çdo shqiptonjë tjetër. Baca ynë ishte liria, bashkimi i të gjithë shqiptarëve. Baca ynë ishte vetë Liria!

29 korrik 2018,
Gani Krasniqi

Baca Adem, Baca i Kosovës! Jam krenare që i takoj kombit të njëjtë me Ju! Emri dhe vepra Juaj është e pavdekshme!

29 korrik 2018,
Hava Morina

Baca Adem, krenohem që të patëm! Shpresoj që Kosova të ndjek rrugën që na e trasove për një Kosovë të prosperuar!

29 korrik 2018,
Drita Kaçandolli-Gjonbalaj

Respekt për Simbolin e Qëndresës shqiptare!

29 korrik 2018,
Fehmi Shala

Respekt Kolosit të madh të Kombit Shqiptar, Adem Demaçi!

29 korrik 2018,
Izet Sylaj

Baca Adem Demaçi - lavdi e përjetshme për jetën dhe veprën Tuaj!

29 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Fat i madh për ne, që e kishim Adem Demaçin!

29 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Kemi pasur fat që e kemi pasur një burrë të madh e të pazëvendësueshëm, Bacën Adem Demaçi!

29 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Respekt i përjetshëm për sakrificën sublime të Bacës, Adem Demaçi!

29 korrik 2018,
Sejdi Osmani, Besi

Ismet Lushi nga familja e të burgosurit politik, nga fshati Babush i Muhaxhirëve. Erdha për të nderuar veprën e njeriut, emri i të cilit nuk do të harrohet kurrë! Lavdi Bacës, Adem Demaçi përjetë e mot!

29 korrik 2018,
Ismet Lushi

Ishit në ballë të luftës për kauzën

e shenjtë kombëtare si askush më parë dhe qëndruat stoik deri në fund, duke u bërë frymëzim për brezat e tashëm e të ardhshëm. Vepra Juaj jetoj Dje, jeton Sot e do jetojë edhe Nesër! Lavdi Bacë!

29 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Ishit Pararojë e lëvizjes kombëtare, një jetë të tërë, Bacë! Vepra dhe kujtimi për Ty nuk do të zbehen me shekuj!

29 korrik 2018,
Agim Manaj

Baca, Adem! Do keni respektin për veprën Tuaj, jo vetëm nga ky brez, por edhe nga shumë breza të tjerë. Lavdi!

29 korrik 2018,
M. Asllani, Fadil B.

Baca Adem, për ne shqiptarët në këtë botë dhe çdo gjë nga vetja. Na e solle Lirinë që po e gëzojmë sot, por na ke obliguar që amanetin Tënd ta dërgojmë në vend, deri në fund!

29 korrik 2018,
Ali Latifi, Prapashticë

Baca Adem, me Ty e vazhduam luftën dhe qëndresën për liri dhe ia dole! I madh do të mbetesh në mendjen dhe kujtimin tonë. Vepra Juaj tu bëftë dritë kudo deri në amshim!

29 korrik 2018,
Q. Krasniqi

I Madh ishe, i Madh do të mbetesh! Lavdi përjetë, Bacë!

29 korrik 2018,
Naim Bujupi

Të qoftë i lehtë dheu i tokës arbërore, për të cilën sakrifikove më shumë se çdo shqiptar!

29 korrik 2018,
Sh. Krasniqi

I përjetshëm do mbetet nderimi dhe respekti për burrin dhe atdhetarin e madh dhe vështirë të përsëritshëm, si Baca Adem!

29 korrik 2018,
Familja Sadriu, Stublla e Gjakovës

Baca Adem, njeriu që i dha vulë Epokës Shqiptare!

29 korrik 2018,
prof. Ibrahim Gashi

Baca Adem, ishe Drita e të gjithë shqiptarëve, i paluhatshëm gjatë kohës sa jetove dhe do të mbetesh i paharruar përjetë!

29 korrik 2018,
Shpend K.

Veprimtarit që duhet t'i përkulen të gjithë shqiptarët. Për Bacën, atdheu ishte mbi të gjitha!

29 korrik 2018,
Veseli Makolli

Bacë, lum si ne që të patëm! Përjetësisht do të mbetesh në memorien e kombit shqiptar!

29 korrik 2018,
Valbona Bajrami

Bacë, erdhëm tok nga Drenica, me nipin e Shaban Polluzhës! Erdhëm të nderojmë Ty dhe ishim të bekuar për këtë! Kujtuam serish Tivarin, Çamërinë, Preshevën e Ulqinin... vazhdojmë tutje!

29 korrik 2018,
B. H

Lajmi se keni ndërruar jetë, Bacë, na erdhi si terr në Kosovë! Po, Ti ishe dritë për ne edhe në momente të vështira. Përgjithmonë do mbetesh fanar drite për çdo atdhetar shqiptar!

29 korrik 2018,
Fadil Hysaj

Ishe i pazëvendësueshëm dhe i tillë do të mbetesh, Baca Adem! I lehtë të qoftë dheu i Kosovës!

29 korrik 2018,
Sebahate Karakashi-Mavriqi

Baca Adem, tërë jetën ta kam pasur lakmi! Jeta juaj është plot lavdi. I lehtë të qoftë dheu i Kosovës. Paqja qoftë me TY deri në amshim!

29 korrik 2018,
Qazim Halilaj, Drenicë

(Vazhdon në numrin e ardhshëm)



Zyrtarët për imigrim arrestojnë 700 persona në Misisipi

WASHINGTON, 8 GUSHT - Zyrtarët amerikanë për imigrim kanë arrestuar pothuajse 700 persona, pas një serie të bastisjeve në shtetin e Misisipit. Operacionet e koordinuara kanë shënjestruar punëtorët në impiante të përpunimit bujqësor që dyshohet se nuk kanë pasur dokumentacionin e

nevojshëm. Në disa fotografi agentët janë parë duke marrë në pyetje dhe arrestuar disa persona. Disa fëmijë janë dërguar nëpër palestra lokale, pasi prindërit e tyre janë arrestuar. Presidenti amerikan Donald Trump ka njoftuar në muajin qershor se do ta shtypë valën e migrantëve "duke dërguar në

shtëpi miliona persona që ilegalisht gjenden në Shtetet e Bashkuara". Këto bastisje kanë ndodhur vetëm disa orë para se presidenti Trump të arrinte në qytetin El Paso të Teksasit për ta vizituar vendin ku kanë vdekur 22 persona si pasojë e një sulmi me të shtëna me armë zjarri.



700 persona marrin gjobë në Francë për shkak të ngacmimit në rrugë

PARIS, 8 GUSHT - Autoritetet franceze kanë lëshuar më shumë se 700 gjoba qëkur një ligj i ri për ngacmimet në rrugë hyri në fuqi vitin e shkuar. Sekretarja franceze për barazinë mes burrave dhe grave, Marlene Schiappa, e ka prezantuar përpjekjen në fjalë si pjesë të një ligji gjithëpërfshirës kundër dhunës seksuale në Francë. "Ne i kemi toleruar ngacmimet në rrugë për shumë kohë. Tani nuk lejohet më t'i fyesh, kërcënosh, ndjekësh apo poshtërosh

femrat në rrugë, në sistemin e transportit apo hapësirat publike. Gjobat do të vazhdojnë!", ka shkruar ajo në një postim në "Twitter" në llogarinë e qeverisë franceze.

Ligji për ngacmimet seksuale mundëson gjoba nga 90 deri në 750 euro për sjellje të pahijshme, të turpshme, komente degraduese për pamjen fizike apo ndjekje të një personi në rrugë. Gjobat mund të shkojnë deri në 1500 euro për krime të përsëritura apo për shkelje në



të cilat përfshihet një minoren/e nën moshën 15-vjeçare, për abuzim me pushtetin apo një varg rrethanash të tjera rënduese. Ligji hyri në fuqi në gushtin e vitit të shkuar, pak javë pasi një studente 22-vjeçare u qëllua në fytyrë nga një burrë të cilin e kishte refuzuar, teksa ky i fundit po e ngacmonte. Incidenti i dhunshëm u fiksua nga kamerat e sigurisë dhe ndezi një valë zemërimi në shkallë kombëtare.

ShBA-ja dhe Turqia arrijnë marrëveshje për zonën e sigurisë në Siri

ANKARA, 8 GUSHT - Turqia dhe Shtetet e Bashkuara ranë dakord të mërkurën të krijojnë një qendër të përbashkët operacioni në Turqi për të koordinuar dhe menaxhuar një zonë të sigurt në verilindje të Sirisë. Ky vendim pritet ta zvogëlojë mundësinë e një ndërhyrje ushtarake turke në atë zonë. Të dyja vendet dhanë pak detaje për marrëveshjen e cila u arrit pas disa ditë bisedimesh.

Kishte mospajtime disamujore lidhur me atë se deri ku duhet të shtrihet zona e sigurt dhe kush duhet t'i komandojë forcat që patrollojnë aty.

Zona e propozuar synon të sigurojë një korridor që shtrihet në më shumë se 400 kilometra përgjatë kufirit verilindor të Sirisë me Turqinë, shumica e të cilit kontrollohet nga milicia kurde, e cila kishte mbështetjen e ShBA-së në luftën kundër militantëve të Shtetit Islamik.



Ankaraja e sheh këtë formacion kurd si terrorist, që paraqesin një kërcënim të madh të sigurisë dhe ka kërkuar që Shtetet e Bashkuara t'i ndërpresin lidhjet e saj me të. Turqia ka dërguar dy herë forca në veriun e Sirisë, në

tre vjetët e fundit, për t'i larguar luftëtarët kurdë dhe Shtetin Islamik nga kufiri. Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, tha të dielën se një sulm i tretë do të ndodhë së shpejti.

Ish-kryeministrja tajlandeze Yingluck Shinawatra fiton shtetësi serbe

BANGKOK, 8 GUSHT - Ish-kryeministrja e Tajlandës, Yingluck Shinawatra, e cila në vendin e saj është e dënuar me pesë vjet burgim, por gjendet në arrati prej kohësh, ka fituar shtetësi serbe. Vendimi për pranimin e shtetësisë është nënshkruar nga kryeministrja e Serbisë, Ana Bërnabiq, më 27 qershor dhe është publikuar në Gazetën Zyrtare më 28 qershor.

Ish-kryeministrja tajlandeze ka pranuar shtetësinë serbe "sipas nenit 19 (1) dhe (3) të Ligjit për Shtetësi". Ky nen parasheh, ndër të tjera, edhe dhënie të shtetësisë në rastet kur është "me interes për Republikën e Serbisë". Megjithatë, nuk është specifikuar se çfarë interesi ka pasur Qeveria e Serbisë për një veprim të tillë. Një gjykatë në Tajlandë e ka dënuar në mungesë Shinawatran me pesë vjet burgim, bazuar në akuzën për neglizhencë në drejtimin e një programi për

subvencione të orizit. Ajo ka drejtuar Tajlandën në periudhën 2011-2014.

Vëllai i ish-kryeministres tajlandeze, Thaksin Shinawatra, po ashtu ka qenë në krye të një mandati qeveritar, që është rrëzuar nga ushtria, dhe tani jeton në mërgim për ta shmangur vuajtjen e dënimit me burgim për korrupsion. Pavarësisht prej dënimit në vendin e tij, më 2009 Shinawatra ka marrë pasaportë si "Qytetar Nderi" i Malit të Zi. Ai ka qenë kryeministër i Tajlandës nga viti 2001 deri më 2006.



Pakistani nuk do konflikt me Indinë, pavarësisht vendimit për Kashmirin

ISLAMABAD, 8 GUSHT - Pakistani ka hedhur poshtë mundësinë e përgjigjes ushtarake ndaj vendimit të Indisë për t'i hequr statusin special rajonit të Kashmirit, pavarësisht prej tensioneve në mes të të dy shteteve. "Ne jemi duke shqyrtuar mundësitë politike, diplomatike dhe ato ligjore. Nuk jemi duke u fokusuar tani në përgjigje ushtarake", ka thënë ministri i

Jashtëm pakistanez Shah Mehmood Qureshi në një konferencë për media në Islamabad.

Pjesa e Kashmirit e banuar me shumicë myslimane, që administrohet nga India, vazhdon të jetë e ruajtur nga forca të shtuara ushtarake, pasi Nju Delhi ka anuluar statusin special që ka pasur ky vend. Linjat telefonike dhe shërbimet e internetit po

ashtu vazhdojnë të mbeten të bllokuara në Kashmir, me qëllim të parandalimit të trazirave. Për Kashmirin kanë pretendime si India ashtu edhe Pakistani, derisa rebelët e pozicionuar nën administratën indiane kanë kryer kryengritje për dekada. Kashmiri është ndarë në mes të Indisë dhe Pakistanit prej përfundimit të rendit britanik më 1947.

Njoftimet e Qureshit kanë ardhur teksa Islamabadi ka bërë me dije lajmin për pezullimin e një shërbimi kyç të trenave me Indinë për shkak të rastit të Kashmirit.

Ministri federal për Hekurudha, Rashid Ahmad, ka thënë se shërbimi i trenave, i ashtuquajtur Miqësia e Shpejtë, do të pezullohet nga 8 gushti. Ky njoftim është bërë teksa udhëtarët kanë qenë



duke pritur trenin në qytetin lindor të Pakistanit, Lahore, për të udhëtuar në Indi.



AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperiencia jonë
- përfitimi i juaj.**

Ju mirëpret:

Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333

E rrallë

Virusi HPV 'pushton' drerin

Një fotografie nga Minnesota ka bërë publike imazhet e një dreri të mbushur me lytha. Sipas saj, ky është rasti më i keq i një kafshe që ka parë në 15 vjet. Julie Carrow fotografoi drerin të mbushur me aq shumë lytha sa nuk mund t'i shihte as sytë. Kjo gjendje i është shkaktuar nga papillomavirus, i njohur më shumë si HPV tek njerëzit. Imazhet janë bërë virale dhe kanë nxitur reagim online që të merren masa për t'i dhënë ndihmë drerit.



FOTO E DITES



Turistët bëjnë fotografi në vendkalimin me xhama në Parkun Pyjor Tropikal Paradise të Yalong Bay në qytetin Sanya, Hainan, Kinë. Fotografia është realizuar nga Imaginechina.

E jashtëzakonshme

Fitoi 10 mijë funte çdo muaj për 30 vjet, tani 24-vjeçari lë punën

Fituesi i një lotarie "10 mijë funte çdo muaj, për 30 vjet" ka zbuluar se si ai e la punën e tij në "Amazon" një ditë pasi gjeti se ishte fituesi, duke dhënë arsytën e tij. Sipas mediave të huaja, Dean Wymes (24-vjeçar), i cili punonte në Departamentin e Transportit për gjigantit e shitjes me pakicë, mbërriti në punë si normalisht në 7:00 të mëngjesit më 30 korrik. Por, kur ai bëri pushimin e tij të parë të ditës, ai mendoi



me vete: "Nuk kam pse të jem këtu nëse nuk dua të jem këtu". Djaloshi nga Peterborough, i cili studioje Video dhe Film në Universitetin Dundalk, në Irlandë, tha se shpreson t'i përdorë fitimet e tij për ta ndihmuar vëllanë e vet me autizëm, Robertin.

BARSOLETA E DITËS



Shkon polici në dyqan: M'i jep dy kilogramë molla. Shitësja: - Çfarë i do, të kuqe apo të verdha? Polici: - Çfarë të duash, sepse para se t'i ha i qëroj.




Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Çdo ditë në ora 15:30 "Spider-Man Far From Home" 3D,

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 09 min
Rolet: Tom Holland, Samuel L. Jackson, Zendaya, Cobie Smulders, Jon Favreau, JB Smoove, Jacob Batalon, Martin Starr, Marisa Tomei, Jake Gyllenhaal

Regjia: Jon Watts



Çdo ditë në ora 17:30

"THE LION KING" 3D

Aventurë/Dramë; 1 orë 58 min

Rolet: Donald Glover, Seth Rogen, Chiwetel Ejiofor, Beyoncé Knowles-Carter, James Earl Jones, Alfre Woodard, John Oliver
Regjia: Jon Favreau



Në ora 19:30 dhe 22:00

"HOBBS & SHAW"

Aksion/Aventurë/Triller; 2 orë 15 min

Rolet: Dwayne Johnson, Jason Statham, Idris Elba, Vanessa Kirby, Helen Mirren, etj.
Regjia: David Leitch



Nga dt. 08.08.2019

"THE ANGRY BIRDS MOVIE 2"

Horror/Triller; 1 orë 39 min

Rolet: Jason Sudeikis, Josh Gad, Leslie Jones, Bill Hader, Rachel Bloom, Danny McBride, Peter Dinklage, Nicki Minaj

Regjia: Thurop Van Orman



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: **Kino ABC**.




DASHI
Një fillim dite i mbarë dhe sot

pirreni ta ndihmoni këdo që ka nevojë për ju. Miqtë dhe partneri janë të lumtur që ju kanë pranë.



DEMI
Bëni mirë të tentoni marrëveshje

jashtë shtetit sepse kanë më shumë mundësi financiare. Do të arrini ta bëni dallimin midis dy personave afër jush.



BINJAKËT
Sot, nëse tregoni gënjeshtra, do të

zbulohen shumë shpejt. Mundohuni të jeni të qartë në gjërat që ju nevojiten për një projekt.



GAFORRJA
Jeni në paqe me veten sot dhe me

personat që keni pranë. Bazohuni në informacionet që keni për të zgjidhur një çështje të komplikuar.



LUANI
Në sytë e njeriut të zemrës duhet

të jeni të përkryer dhe kjo ju bën të jeni sa më të vëmendshëm dhe në detaje ndaj vetes tuaj.



VIRGJËRESHA
Jeni të ndrojtur dhe mjaft të

rezervuar në çfarëdo situatë që ju paraqitet sot. Temperamenti juaj nuk ju lejon të bëni eksperimente.



PESHORJA
Momente të së shkuarës ju vijnë në

mendje, por pa qenë aq shumë thelbësore në vendimet tuaja të së tashmes. Një surprizë e këndshme do t'ju befasojë.



AKREPI
Megjithëse me buxhet të reduktuar

kohët e fundit, pasuria e brendshme është aq e bollshme sa ndiheni personi më i pasur në botë.



SHIGJETARI
Çdo gjë përreth jush buzëqesh

sot sepse edhe ju vetë i falni buzëqeshjet pa kërkuar asnjëherë asgjë në këmbim.



BRICJAPI
Miqësitë e reja do t'ju tregojnë që jeni

persona që te të tjerët përçoni veçse mirësi dhe energji pozitive. Kjo gjë do t'ju shoqërojë edhe në ambientin e punës.



UJORI
E kotë që përpiqeni të fshiheni

pas gishtit. Sot në çdo çast do të krijoni tensione që nuk janë shumë të nevojshme.



PESHQIT
Keni vendosur të jeni besnik të

ideve tuaja fillestare dhe do t'i mbronni ato pa bërë kompromise. Kjo gjë mund t'ju penalizojë në disa raste.

Vëllezërit Jonas rikthehen me turne



Jonas Brothers bënë një rikthim të fuqishëm në skenë me turneun "Happiness Begins". Treshja e famshme e nisëm rrugëtimin e shumëpritur të mërkurën mbrëma në Miami. Turneu, në mbështetje të

albumit të tyre të ri, është planifikuar ta përfshijë gjithë Amerikën e veriut dhe Evropën, përfshirë edhe koncertin e tyre në Paris më 22 shkurt të vitit të ardhshëm. Djelmohat performuan shumë nga hitet e tyre të kaluara.

Emily Ratajkowski mban qafore me inicialet e burrit



Emily Ratajkowski duket se është ende në muajin e mjaltit me bashkëshortin e saj Sebastian Bear-McClard. Modeluesja 28-vjeçare, që e ka kurorëzuar dashurinë me aktorin dhe producentin në muajin shkurt

të vitit 2018, është parë me një qafore që mban inicialet e bashkëshortit të saj. Ratajkowski në një fotografi që e ka postuar në "Instagram" kishte vendosur disa qafore me ngjyrë ari, ku njëra nga to e mbante shkronjën "S".



Millie Bobby Brown, fytyra më e re e 'Pandora'-s

Aktorja e njohur Millie Bobby Brown dhe kompania e bizhuterive 'Pandora' janë bërë bashkë për ta festuar fuqinë e vet shprehjes. Brown është fytyra më e re e Pandoras ku janë duke bashkëpunuar për një kampanjë e cila promovon stilin personal

dhe forcën e saj. Sipas "People", 15-vjeçarja është duke e promovuar kampanjën në qytetin e lindjes Atlanta të Gjeorgjisë. "Unë e dua Pandorën sepse të gjithë mund ta tregojnë stilen e tyre dhe çdo simbol mund ta paraqesë personalitetin tuaj", ka thënë Brown për "People".

Keanu Reeves nuk njihet në rolin e ri



Fansat e Keanu Reeves nuk do ta njohin aktorin e tyre të preferuar për shkak të pamjes krejtësisht tjetër që e ka marrë për rolin në "Bill & Ted Face the Music".

Ai do të kthehet në rolin e tij jashtëzakonisht të popullarizuar të Ted 'Theodore' Logan në këstin e tretë të serisë klasike të filmit në vitin e ardhshëm.

Intervistë me akademik Ali Aliun

AKADEMIA ËSHTË ASHTU SI KOSOVA

Intervistoi:
Berat ARMAGEDONI
Fotografinë e autorit:
Besnik HAMITI

Profesor i nderuar, jetëshkrimin tënd zyrtar e gjejmë kudo në faqe të internetit, edhe në uebfaqen e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Megjithatë, në jetëshkrim letrar, më i hollësishtëm, më i natyrshtëm, na duhet për lexuesit e revistës veçan nga ju. Çfarë do të përzgjedhni, nga jeta dhe veprimtaria juaj shkencore, të na rrëfeni për tetë dekadat e gjysmë të jetës suaj? Po ju bëjmë me dije se duam të dimë për fëmijërinë, për adoleshencën, për maturinë, për pjekurinë, për moshën tuaj të shtyrë, edhe për ditët e zakonshme në Prishtinë.

Po, lindur jam në Kranjë që, mbi kokë, në lindje, ka malin Pelister dhe në perëndim liqenin e Prespës. Ndër kujtimet e para mbaj mend ditën kur ushtarët italianë, me barka, zbarkuan nga liqeni i Prespës, ku ishte kufiri, atëherë dhe sot, me Shqipërinë. Në pritjet të karabinierëve italianë në rrugë ishte i tërë Kranji, gra dhe bura, pleq dhe fëmijë, duke i shoqëruar udhëve me daulle e gërneta, diku edhe me lule. Ishte pranverë e hershme dhe Kranji, i cili ka shumë ujëra nga burimet e Pelisterit, dhe vijat anash ishin përplot me ujë, e që vende-vende i mbulonin edhe udhët. Ne fëmijët vraponim zbathur për t'i ndjekur nga pas mysafirët me uniforma, edhe disa pa uniforma, burra të ardhur nga Shqipëria bashkë me ta. Më kujtohen copëza fjalësh e fjalish nga ajo që thoshin mysafirët dhe që përcillej në turmë si, për shembull: "Mos ishte gjoli, para se të vinim ne në Kranjë do të vinte bullgari". Pra, ata i paskëshin rënë trup liqenit pa shkuar rrotull dhe kishin mbërritur ta vënë kufirin me Bullgarinë përpara Kranjit. Ndërsa para këtij kujtimi, natyrisht më të zbehtë, gati si nëpër një ëndërr, më kujtohet Dita e

Nevruzit, kështu i thoshte gjyshja Meleke, kështu i thoshim edhe ne. Gjyshja ishte myhype që kishte marrë dorë në teqenë bektashiane, në atë të Baba Saliut në Manastir. Dhjetë ditë para festës Nevruz vetëm gjyshja në shtëpinë tonë nuk pinte ujë. Unë flija me të, se nëna më kishte lënë gjashtëmuajsh. Gjatë ditëve të matemit babai merrte një libër që e quante Qerbela, i cili rrinte gjithnjë mbi kurrizin e një ore të madhe të varur në mur që binte si kabanë dhe na ulte të gjithë në rreth për të na lexuar luftën e imam Aliut kundër Jezitit, Mavijes. Gjyshja zakonisht qante.

Pas ca kohe në Kranjë u hap shkolla shqip. U mbush oborri i një ndërtese njëkatëshe, që kishte qenë shkollë në gjuhën serbe. Për herë të parë shihja aq shumë fëmijë në Kranjë, i cili asokohe kishte rreth katërqind shtëpi thoshin dhe që unë shumicën nuk i kisha parë asnjëherë. U lidh Kranji atëherë me Korçën meqë Prespa ishte nënprefekturë e Korçës, prej ku erdhën katër mësues nga Shqipëria. Nëpër klasa na ndanë sipas moshës dhe sipas nxënësve që deri atëherë shkonin në shkollën serbe. Në klasën e parë, ku më regjistruan edhe mua, kishim një mësuese me emrin Dhorka Qelesi.

Kur erdhën partizanët në Kranjë, si dhe në fshatrat e tjerë të Prespës, u hapën shkollat deri në klasën e katërt. Pasi mbaruam klasën e katërt që na kishte mbetur pa e kryer nga koha e Italisë, mua më dërguan në shkollë në Manastir, ku asokohe vetëm atje kishte tetëvjeçare. Ishim një grup nxënësish nga Prespa dhe jetonim në konvikt. Vite më pas do ta mësoja se ndërtesa e konviktit paskësh qenë vendi ku ishte mbajtur Kongresi i Manastirit.

Kur erdhët nga Kranja në Prishtinë, pasi kryet studimet për albanologji në Beograd, erdhët për të mos u kthyer më në juglindje të Prespës?

Në fillim të viteve pesëdhjetë, dy



vjetët e para të Normales i bëra në Tetovë. Në këtë qytet, që gjatë periudhës italiane kishte qenë qendër prefekturë dhe ku gjatë atyre viteve ishte ngritur një bibliotekë e pasur, për herë të parë rashë në libra shqip. Në konviktin e Manastirit gjatë katër vjetëve mbaj mend që kisha lexuar ndonjë libër në maqedonisht, pa mu kujtuar mirë titullin e librit apo autori. Gjatë luftës dhe pas ikjes së Italisë, siç thoshin banorët e Tetovës, librat e bibliotekës kishin përfunduar në biblioteka private. Një nga vajzat e klasës sonë, tetovare me mbiemrin Malaziu (nuk më kujtohet emri), filloi të më sjellë herë pas here libra nga shtëpia, pa ndonjë rend, çfarë i binte në dorë. Atje për herë të parë e kam prekur me dorë dhe lexuar romanin e Dostojevskit "Krimi dhe dënimi", më duket në përkthim të Tajar Zavalanit. Kështu fillova të lexoj libra çfarë më binin në dorë. Pas dy vjetëve të qëndrimit në Tetovë, Shkolla Normale, e vetmja shkollë e mesme shqip në Maqedoni, u zhvendos nga Tetova në Shkup. Në kryeqytet ishim më komodë me hapësirë, një ndërtesë e madhe me oborr, ku ishte vendosur edhe shkolla edhe konvikti, në qendër të qytetit, por nuk u familjarizua asnjëherë me qytetin, siç ndjeheshim në Tetovë, ku qyteti na dukej si shtëpia jonë.

Nga gjysma e viteve pesëdhjetë të shekullit të kaluar e deri në fillim të dhjetëvjetëshit gjashtëdhjetë vazhdova në Beograd, banor i qytetit të studentëve. Një mjedis me rreth pesëdhjetë mijë banorë - studentë nga mbarë Jugosllavia e atëhershme. Në Katedrën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, pranë Fakultetit Filozofik të Beogradit, në gjuhën shqipe

na ligjëronin: profesor Vojislav Dancetoviq dhe profesor Idriz Ajeti gjuhën shqipe, ndërsa profesor Anton Çetta letërsinë shqipe. Të gjitha lëndët e tjera i dëgjonim në gjuhën serbe, ku lënda bosht dhe kryesorja ishte Letërsia jugosllave, që dëgjohej gjashtë semestra me më shumë profesorë, dhe Teoria e letërsisë katër semestra. Katedra jonë për çdo vit kishte rreth dhjetëpesëmbëdhjetë studentë. Kishte një bibliotekë modeste të librit shqip, kryesisht botime të "Rilindjes". Me autorë dhe libra nga letërsia jugosllave - në program të saj ishin letërsitë e gjashtë republikave dhe ndonjë autor nga dy krahinat, biblioteka ishte e furnizuar me bollëk. Sa më kujtohet, bibliotekës në katedrën tonë asokohe i vinte revista "Nëntori" nga Tirana, në faqet e së cilës mbaj mend të kem lexuar prozë nga Shuteriqi, Ali Abdihoxha, Kim Dushi, Musaraji. Gjatë viteve të kaluara në Beograd kohën më të madhe e kaloja me lexim të librave, sidomos lexoja veprat e klasikëve të shekullit nëntëmbëdhjetë. Frekuentoja rregullisht tribunën e njohur Kolarc, në kuadër të Universitetit të Beogradit. Aty kisha rast të përcjell takime dhe biseda, pos me shkrimtarë të njohur jugosllavë, edhe me emra të shquar ndërkombëtarë. Isha, gjithashtu, vizitor i parapaguar, me biletë vjetore për studentët, në teatrin jugosllav të dramës (Dramsko Jugoslovensko Pozoriste), në skenën e të cilit në ato vite, duke qenë ende student, filloi të shfaqet në role episodike aktori shqiptar Bekim Fehmiu. Pas studimeve u ktheva në Shkup dhe u punësua gazetar në redaksinë e gazetës së përjavshme Flaka e Vëllazërimit, vend në të cilin gati se e mbylla

decenien e viteve gjashtëdhjetë. Në këtë të përjavshme të vetme në gjuhën shqipe në Maqedoni mbaja dy faqe gazete për kulturë dhe arsim. Nga kultura përmblidhja ngjarjet në fushën e letërsisë dhe teatrit. Në Shkup gjatë atyre viteve kishte vetëm një teatër shqiptaro-turk, ku një ndërtesë dhe një skenë e ndanin dy pakicat, si emërtoheshin shqiptarët dhe turqit asokohe. Nga fundi i viteve gjashtëdhjetë doli edhe revista e parë letrare në gjuhën shqipe Jehona. Shumë rrallë botohej edhe ndonjë libër shqip, e më shpesh libra të përkthyer nga autorë jugosllavë. Në Shkup, por edhe në qytetet e tjera të Maqedonisë, qysh në atë kohë kishte ngjarje dhe manifestime letrare, si Mbrëmjet poetike strugane e shumë të tjera, të cilat redaksia jonë kishte obligim t'i përcjellë. Fillova kështu ta njoh botën kulturore, e sidomos letërsinë maqedonase. Jashtë obligimit të kësaj natyre vazhdimisht një sy e mbaja drejt Prishtinës, ku në institucionet arsimore dhe kulturore e publicistike ishin përfshirë shumica e kolegëve të mi nga koha e studimeve në Beograd. Prandaj fillova të botoj herë pas here në faqet e gazetës Rilindja në Prishtinë, sidomos shkrime për teatrin, letërsinë, por edhe për manifestimet letrare të Shkupit. Natyrisht, ajo që më së shumti më tërhiqte gjatë viteve të mia të gazetarisë në Shkup ishte letërsia. Duke informuar për manifestime letrare, për libra të përuaruara dhe të vlerësuara me çmime vjetore, duke bërë informimin fillestar për përmbajtjen e tyre, me kohë fillova që këtë aktivitet ta përcjell edhe me ndonjë koment, me pretendime vlerësuese, që u bë më vonë



fusha në të cilën unë u përqundrova.

Në fillim të viteve të shtatëdhjeta të shekullit të kaluar u vendosa në Prishtinë. Fillimisht, në dy vjetët e para në shtëpinë botuese Rilindja bashkë me Ramiz Kelmendin, Rrahman Dedajn, Fahredin Gungën, Nazmi Rrahmanin të cilët, së bashku me shkrimtarë të tjerë, si Azem Shkreli, Anton Pashku, Ali Podrimja etj. kishin botuar librat e parë dhe kishin bërë emër. Redaksia e botimeve Rilindja, që asokohe ishte ngritur në një shtëpi të shqiptarëve nga mbarë Jugosllavia, brenda këtij aktiviteti, në gjirin e vet kishte themeluar edhe një bashkëpunim, sado të kufizuar, me redaksinë e botimeve Naim Frashëri të Tiranës. Pos një numri botimesh të gatshme që shkëmbeu, ata na dërgonin edhe vepra në dorëshkrim, ende të pabotuara atje, që ne të mënjanonim çfarë nuk shkonte dhe çfarë nuk mund ta blunte mulliri i këtushëm dhe i botonim. Po në këtë periudhë për herë të parë Rilindja filloi të botojë romane në dorëshkrim, siç ishte edhe Kështjella e Ismail Kadaresë, që e kam lexuar në dorëshkrim. Në këtë hark kohor bashkëpunimi, filloi edhe seria e veprave komplete, gjithnjë për herë të parë në hapësirën shqiptare, me opusin letrar të Petro Markos, prozën e Ali Abdihozhës, kompletin e romaneve të Jakov Xoxës, seri ku më pas, nga gjysma e dytë e viteve shtatëdhjetë, për herë të parë do t'i botohet kompleti i veprave edhe Dritëro Agollit, Ismail Kadaresë, Eqrem Çabejit etj. Është për t'u theksuar se të gjitha këto vepra dhe autorë që i përmenda dhe botime të tjera në tregun e Kosovës gati se shiteshin brenda ditës. Ekzistonte një

entuziazëm i madh tek të rinjtë, sidomos ndër studentët e Universitetit të Prishtinës. U gëzoheshin botimeve letrare, organizoheshin takime të shpeshta të shkrimtarëve në Kosovë dhe jashtë Kosovës me lexues, më rrallë edhe me shkrimtarë nga Shqipëria. Në Prishtinë, pas brezit të Esat Mekulit, Hivzi Sulejmanit, Tajar Hatipit, Zekeria Rexhës, që ishin bërë gati klasikë, ishin afirmuar edhe emra si Enver Gjerqeku, Ramiz Kelmendi, Rexhep Hoxha etj. dhe, pas tyre, brezi i autorëve të përmendur pak më sipër si Azem Shkreli, Rrahman Dedaj, Ali Podrimja, Nazmi Rrahmani, Fahredin Gunga, Din Mehmeti, Besim Bokshi, po shfaqeshin edhe më të rinjtë, si: Sabri Hamiti, Zejnullah Rrahmani, Eqrem Basha, Mehmet Kraja, Teki Dërvishi, Beqir Musliu, Musa Ramadani etj.

Interesimi juaj, prej fillimit të studimeve e deri më sot për filologji, në bazë të biografisë dhe bibliografisë suaj, ka qenë kritika për letërsinë, studimet për të. Meqë keni hartuar edhe tekste shkollore dhe antologji, i njihni edhe temat e vogla dhe të mëdha, të rëndësishme dhe të parëndësishme e letërsisë shqipe, natyrisht edhe shkrimtarët. Mund të na thoni pse u bë i njohur në botë Kadareja e jo, ta zëmë, Petro Marko, për jetën dhe veprimtarinë e të cilit keni doktoruar?

Ju përmendët, pak edhe komentuat autorët Ismail Kadare dhe Petro Marko. Janë dhe nuk janë të ngjashëm, përpos që të dy të talentuar por, të ndryshëm. Petro Marko lindur në Dhërm të Himarës më 1914 - poet, tregimtar, gazetar i rebeluar që në vitet tridhjetë në Tiranë. Luftëtar në Spanjë në pjesën e dytë të viteve tridhjetë, beteja dhe kalvaresh të ndryshme luftarake nëpër Evropën antifashiste. Ai u ballafaqua që në moshë të re me sfida jetësore për jetë a vdekje. Pas luftës, në Tiranë e çliruar, ai do të refuzojë komoditete personale (refuzon shtëpinë e një të deklasuari, nga e cila nxirret përjashta pronari), refuzon bashkëpunimin poshtëruar mes gazetës shqiptare Bashkimi dhe gazetës beogradase Borba, mbetet rebel në thelb edhe përballë pushtetit të ri komunist. Pajisur me një talent me ngasje rezistuese ndaj deformiteteve, të kujtdoqofshin dhe të kurdoqofshin, që ai do ta bëjë këtë me sjellje dhe veprime të përditshme, po edhe si krijues, sa herë gjente pak hapësirë, pa ëndërruar vendin në panteonin e krijuesve. Thjesht, ishte mënyrë e jetës, natyrë e lindur e tij, që e manifestoi që në hapat e parë këtë synim, këtë filozofi jetësore si njeri dhe si shkrimtar.

Për nga nivelin artistik, për bindjen dhe shijen time, veprat e këtyre dy shkrimtarëve dallojnë shumë

pak. Megjithatë, na thoni, si u bë që Petroja mbeti shkrimtar i shqiptarëve dhe i pak të tjerëve e Kadareja i dyzet kombësive?

Ismail Kadareja, lindur në Gjirokastrë më 1936, luftën që zëmë ngoje më sipër e jetoi si fëmijë. Shkollohet në epokën dhe rendin socialist, në komunizëm. Talent gjenial, mendimtar, ai e kupton në thelb objektivin e programuar ideor të kohës dhe me kohë krijon sistemin mbrojtës fizik dhe krijues. Natyrshëm do ta projektojë universin e vet letrar duke hapur krahët kohorë drejt rrënjëve të etnisë ndër shekuj, shtresimeve perandorake mbi hapësirën arbërore, epoka kohore këto që do të komunikojnë nën tokë mes vete përmes gjuhës së koduar dhe do t'ia dalë që t'i ofrojë lexuesit shqiptar, edhe në kushte diktature, dalje imagjinare nga izolimi me veprën romanore gjeniale.

Petro Marko thjesht abuzoi me talentin e vet, duke e konsideruar atë dhuratë që duhet përdorur si armë të ditës, pa ëndërruar amshimin. Mund të thuhet se në këtë vijë mund të jetë e përngjashme afërsisht ajo e Dritëro Agollit, gjithashtu me talent të madh, që ia doli edhe nën darët shtrënguese të sistemit të japë një kryevepër si Shkëlqimi dhe rënia e Shokut Zylo, që është sfida më e madhe e asaj periudhë letrare shqiptare që i bëhej aktualitetit, por edhe me ndonjë dramë si dhe me romanin Arka e Djallit dhe disa tregime.

Me shqiptarët e Shqipërisë, që qëllimisht po shprehem kështu, kemi një komb, kemi një gjuhë, një zemër dhe një shqiptarë të përbashkët e çka jo tjetër, po bashkëpunimin ndër-institucional dhe ndërakademik nuk e kemi kurrqysh. Ministritë e Kulturës hartojnë kalendar të aktiviteteve kulturore, po ditët kalojnë para tyre pa u vënë re dhe bërë gjë për kulturën. Bashkëpunim edhe më të keq kanë Ministritë e Arsimit. As Akademitë bashkëpunim më të mirë nuk kanë. Pse?

Mund të thuhet se vitet shtatëdhjetë janë vitet e një zhvillimi shpërthyes në të gjitha fushat në Kosovë. Ajo edhe pse nuk e kishte siglën e republikës brenda ish-Jugosllavisë, i kishte pothuajse tërë nishanet e saj. Ishte dhjetëvjetëshi kur përjetoj një hov të paparë arsimor, kulturor dhe shkencor. E përfshirë nga një entuziazëm shpërthyes, nga një zgjim i brendshëm që mëtonte ta zërrë ritmin e humbur në kohë, Prishtina u bë qendër arsimore dhe kulturore për mbarë shqiptarët në Jugosllavi. Universiteti i saj po radhitej pa u skuqur brenda dymbëdhjetë të tillëve në hapësirën e atëhershme jugosllave. Rektori të rangut si Gazmend Zajmi me shokë, edhe kur e kishin radhën sipas rotacionit të atëhershëm, të udhëheqin bashkimin e univer-

siteteve jugosllave (një organizim i tillë i atëhershëm), shfaqeshin të barabartë, por shpesh edhe superiorë. Njësoj, sipas të njëjtit rotacion, edhe në Lidhjen e Shkrimtarëve të Jugosllavisë, kur ajo udhëhiqej nga poeti Azem Shkreli, që si krijues dhe intelektual qëndronte midis majave, shkëlqente gjithashtu. Në këtë kontakt dhe hapësirë kohore ndodhi edhe bashkëpunimi larsimor dhe kulturor në mes të Prishtinës dhe Tiranës. Në fakt, ishin dy porta të hapura: mes dy universiteteve dhe dy shoqatave të shkrimtarëve, asaj të Kosovës dhe të Shqipërisë. Nën këtë ombrellë bashkëpunimi u përfshi një numër i madh profesorësh nga Universiteti i Tiranës, me leksione gati të rregullta, sidomos në fakultetet me mungesë kuadrosh nga fusha e shkencave ekzakte dhe mjekësore, por edhe në albanologji. Kishte shkëmbim institucionesh albanologjike, historike, shkëmbim shfaqjesh teatrore, ansamble dhe koncerte muzikore, shoqata folklorike etj. Ju po më pyetni pse nuk mund t'i heqim barrierat e bashkëpunimit të paktën në këto fusha sot. Është pyetje para së cilës njeriu i ngre supet. Të shkon mendja nganjëherë të thuash mbase pse nuk na rri mbi kokë një shpatë që kërcënon dhe ta ndërpret çdo bashkëpunim të mundshëm sa herë të dojë dhe sa herë t'i teket. Mbase mos jemi natyrë që kur na lihet vetvetja në dorën tonë, jemi shpërdorues të lirisë, të vetvetes. Ju po thoni se një bashkëpunim i tillë i mungon edhe Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë. Kjo qëndron pjesërisht. Në mes të dy Akademive për çdo vit nënshkruhet një protokoll bashkëpunimi i dyanshëm dhe gjatë çdo viti mbahen dy deri në tri konferenca, tryeza të përbashkëta. Po ashtu, ekzistojnë marrëdhënie të mira pune ndërpersonale. Mungojnë projektet afatgjata që nuk mund të ndodhin pa përkrahjen e nevojshme nga shoqëria, kur është fjala për këto nivele bashkëpunimi.

Jeni anëtar i rregullt i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës që, së paku, njëzet vjet. Ç'bëhet aty, profesor?

Po më pyetni ç'bëjmë ne në Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Që në fillim dua t'ju them fare shkurtimisht që bëjmë edhe ne ca punë të mira. Anash perceptimit që për këtë institucion përpiqen të krijojnë individë të cilët e kanë brengë konstante ASHAK-un. Por, megjithatë, dëshiroj një ndërhyrje, ose thënë ndryshe një digresion. Si mund të jetë një institucion nga fusha e kulturës, e shkencës, e arsimit, një universitet, një institut, një shkollë, ose në këtë rast një akademi ndryshe nga ç'është Prishtina, Kosova. Nëse shumë çfarë nuk është në rregull shikuar nga kjo perspek-

tivë, nga ky realitet, s'mund të ketë përjashtime të izoluar. Si mund të jetë në rregull një institucion, i cilësdo fushe qoftë, kur brenda realitetit tonë të gjitha të mirat e vendit gati se janë bërë plaçkë publike e përditshme nga të zgjedhurit e popullit. Në një realitet ku qyteti ku jetojmë, kryeqyteti ynë, është katandisur në një vend plehrash, me lagje dhe rrugë ku herë njëra e herë tjetra gropohen e baltosen herë për nevoja kanalizimi e herë për drita e herë për ujë, për të qenë sa më të shpeshtë tenderët. Që ato bllokohen ua bëjnë zi përditshmërinë qytetarëve, duket fare normale dhe me të cilën të gjithë mësohen. Dhe ky ASHAK-u, të paktën, s'ka lejuar të kontaminohet nga kjo ndotje.

Vitin e kaluar ASHAK-u botoi "Fjalorin enciklopedik të Kosovës". Kushtoi shumë, u shkrua dhe u fol shumë për të, për të metat e tij. Nuk shkruan keq për të vetëm të pakënaqurit e të papërfshirët në zëra, po edhe ata që u angazhuan për hartimin e tij dhe ata që zënë vend aty. Po mos të ishit anëtar i ASHAK-ut e po mos ta përgatisnin kolegët e tu atë fjalor, çfarë do të shkruanin për të?

Po, Fjalori Enciklopedik është një vepër e rëndësishme kulturore, është ngjarje kulturore, projekti më i rëndësishëm dhe më i mirë i saj deri më sot, i asaj dhe i Kosovës në fushën kulturore dhe shkencore. Natyrisht që Fjalori Enciklopedik ka lëshime. Brenda gjashtë mijë zërave, sa përfshihen në të, mund të ketë, mbase, edhe me dhjeta që nuk e kanë vendin, ose me dhjeta që mungojnë. Në përzgjedhjen dhe hartimin e tyre është përfshirë një numër i madh bashkëpunësorësh të fushave që vijnë nga jashtë. Shumica dërrmuese e teksteve, nga të angazhuarit për zërat në fjalë, janë rishikuar nga anëtarët e redaksisë qendrore dhe sidomos nga kryeredaktori. Është projekti i parë enciklopedik në Kosovë që në fushën e kësaj shkence na ka munguar... Por më lejoni edhe një vëmendje lidhur me ASHAK-un. Duket se kjo Akademia jonë, e përzgjedhur edhe si portë hyrëse e revistës suaj, e paska të thënë të jetë e pranishme shpesh, nëse jo në çdo numër... Parafolësi im në përgjigjen tuaj ishte më zeusian, më bubullues: thirri në ndihmë fjalorin për t'i gjetur fjalët më vulgare për të na e bërë portretin... Të jetë përçartje përcudnuese poeti dhe prozatori, le të themi i mirë, siç thoni ju... Po kolegët e tij, që nga fillimi: Mekuli, Pashku, Bokshi, Podrimja, Hamiti, Basha, Rrahmani, Kraja, meritojnë t'ua hedhë gjithë atë vlerë? Shihu në pasqyrë, do t'i thosha, kur je esëll, po munde: mos do të dukesh pak larg të qenit pranë tyre?

Vijon nga faqja 17

Profesor, ASHAK-un do ta bënit më të mirë po qe se, vazhdimisht, problemet e brendshme të saj do t'i nxirrnit jashtë. Janë diskutimet ato që nuk i lënë njerëzit të gabojnë. Dhe, meqë jeni edhe anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë (ASHAM), ajo jo pak herë ka botuar tekste me mllef dhe urrejtje ndaj shqiptarëve. Kur e pati botuar enciklopedinë, në 2009-n, përplot me urrejtje për shqiptarët, patët deklaruar dorëheqjen nga anëtar i nderit të saj sepse në atë enciklopedi ishte edhe emri juaj. Por, dorëheqje nuk dhatë. Pse? Dhe, si i keni raportet e bashkëpunimit sot me ASHAM-in?

Po, kam deklaruar atyre ditëve, kur ngjau skandali në enciklopedinë e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë, se do të jap dorëheqje nga të qenit anëtar i jashtëm i këtij institucioni. Por pas debatesh dhe përplasjesh të ashpra dhe të pakompromis, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Maqedonisë e tërhoqi nga tregu enciklopedinë e kritikuar. Dhe si hap të dytë ky institucion botoi të përkthyer në maqedonisht "Historinë e Popullit Shqiptar" nga historiani Kristo Frashëri që është, mbase, historia më komplete (e kësaj natyre) që kemi. Vuri në projekt, gjithashtu, hapjen e një bërthame për shkencat albanologjike brenda Akademisë. Po pas kësaj ngjarjeje, kryetari i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë, asokohe Vllado Kambovskinë, vizitën që i bëri ASHAK-ut, në bisedë para gazetarëve kërkoi edhe falje publike, duke thënë se pikërisht duhet të jemi më afër, të bashkëpunojmë, ta njohim njëri-tjetrin, që të mos gabojmë.

Jetoni në kryeqytetin e Kosovës, në të cilin, më shumë se në cilindo qytet të saj, promovohet disi kultura dhe, po ashtu, disi arsimit dhe shkenca. Si ju duket veprimtaria kulturore, arsimore dhe shkencore që zhvillohet përreth jush, në seminare ndërkombëtare që organizojnë fakultetet, në konferenca shkencore të instituteve dhe të akademive?

A bën jetë kulturore Prishtina? Natyrisht se po. Kultura është kuptim i gjerë. Edhe të jetuarit bashkë, të mësosh të jetosh bashkë në një qytet, lagje, rrugë, pallat, është kulturë. Në botë ka nivele të ndryshme kulturore. Në rrugë, në shesh, në pallat, në kafene, në autobus, dhe kudo përbëjnë faqen kulturore të qytetit. Dhe, shikuar kështu, nga të gjitha aspektet kemi atë shkallë të jetës kulturore që bëjmë. Në këtë shkallë kulturore e bëjmë jetën kulturore institucionale: teatrin, filmin, letërsinë, koncertet, sallat muzikore, stadiumet, sportin, shkollat. Në këtë



shkallë institucionale kemi akademi dhe institute kulture, të arsimit, të shkencës etj. Dhe i kemi të tilla çfarë i kemi krijuar dhe i meritojmë. Por, ju veçanërisht po më flisni për jetën letrare, për atë fushë ku bëjmë pjesë bashkërisht, unë si individ dhe ju si revistë letrare dhe si themelues dhe përgjegjës i saj. Në Prishtinë e në Kosovë tanimë ka një traditë letrare: vetëm që nga Lufta e Dytë e këtij ajo po afron të përmbyllë një shekull të tillë. Gjatë këtij harku kohor, ajo, letërsia pra, ka mbërritur majat e letërsisë kombëtare me emrat si: Azem Shkreli, Ali Podrimja, Anton Pashku, të përmend pra vetëm disa nga ata që s'janë mes nesh. Të përmend disa edhe nga emrat e brezit që pasuan pas tyre, si: Eqrem Basha, Sabri Hamiti, Mehmet Kraja, Zejnullah Rrahmani etj., dhe brezi që i pason me emrat Basri Çapriqi, Milazim Krasniqi, Ibrahim Berisha, Abdullah Konushevci, Lindita Tahiri, Fatmir Sulejmani, Shaip Beqiri... etj. Por, le të afrohem edhe me emrat si Kujtim Shala, Nysret Krasniqi, Agron Gashi, Gëzim Aliu, Muhamet Hamiti, Lindita Ahmeti, Salajdin Saliu, Kujtim Rrahmani, Ballsor Hoxha, Albatros Rexhaj, Arta Arifi, Ag Apolloni, Albana Mehmetaj, Azem Deliu... Breza që kapen pas njëri-tjetrit dhe e ruajnë ritmin e vazhdimësisë mes vete, natyrisht me ngritje dhe rënie. Për bindjen time, letërsia shqipe në Kosovë, sidomos ajo e njëzet vjetëve të fundit, pos prurjeve të autorëve të njohur të paraçlirimit, pra të shekullit të njëzetënjë, është në fazë kërkimi. Si letërsi shqiptare në përgjithësi, edhe tridhjetë vjet pas daljes nga diktatura, truallit ynë letrar është në pritje të një vepre përmasash totale për atë epokë.

Disa prej autorëve që i përmendet, prej këtyre të fundit, s'ma mbushin mendjen që dinë të shkruajnë as letërsi, as kritikë letrare. I paskemi shijet e ndryshme, profesor. Dhe, shqyr! Meqë është punë e shijes sonë, s'po e gërgasim më shumë krijimtarinë e tyre. Por, t'ju pyes diçka tjetër tash. Edhe pse nuk e bëni më punën e redaktorit të redaksive letrare, zhvillimet e letërsisë shqipe i përcillni. Çfarë po krijohet sot më shumë dhe çfarë do të duhej të krijohet?

Në tërësinë letrare të shqipes brezi që shkeli për herë të parë në fushën e letërsisë gjatë tridhjetë vjetëve të fundit, ende me përballjen e vërshimit të veprave dhe autorëve të përkthyer dhe autoktonë, nuk po arrin dot balancë. Vrapit pas trendëve dhe modave, i autorëve dhe lexuesit, është dëshmi i asaj që thashë për një fazë kërkimi. Edhe në Kosovë ka ndonjë shpërthim zëri individual, me temë nga e kaluara dramatike, që kryesisht vjen edhe si një shtysë nga mëtimi për të bërë emër me çdo kusht dhe shpejt; shpesh edhe me klithje, abuzime për ta tërhequr vëmendjen, si një model i pushtetarëve që brenda natës të bëhen milionerë. Edhe në kohën e të qenit nën administrimin jugosllav serb, brenda një autonomie gjysmë të varur, gjysmë të pavarur gjatë viteve shtatëdhjetë-tetëdhjetë e këtij në Kosovë, edhe nën diktaturën komuniste të egër në Shqipëri, funksionoi një bashkëpunim kulturor dhe arsimor këndej dhe andej kufirit. Ashtu siç e përmenda edhe më sipër, ai bashkëpunim ishte i kontrolluar, i programuar dozash rreptësisht të kufizuara, por brenda asaj pak hapësire ai funksionoi. Ishte i kufizuar dhe programuar

paraprakisht numri i botimeve brenda një viti të caktuar, këndej dhe andej, me kusht që këtu në Kosovë vepra të mos kishte probleme ideologjike. Kurse autorët dhe veprat nga Kosova që botoheshin në Tiranë kalonin nëpër redaktime rigorozë, duke përzgjedhur - sipas ideologjisë të atëhershme në Tiranë, që të mos depërtojë ndonjë ndikim modernist dhe dekadent i Perëndimit. Prandaj vjen një si nevojë në fund të një bisede të tillë, të pyesim se ku treti dhe si u zhduk ai entuziazëm dhe vullnet i viteve shtatëdhjetë të shekullit të kaluar që i dha vullnet dhe krahë të paparë ambientit vetëm nga një derëz e vogël komunikimi mes Shqipërisë nën një diktaturë të egër dhe Kosovës gjysmë të robëruar. Dhe ky zvetënim në fushën e letërsisë nuk ka si të mos vërehet edhe në një pjesë dërrmuese të prurjeve më të reja të kulturës, artit, shkencës, arsimit shqiptar sot.

Cila periudhë e letërsisë shqipe, cilët shkrimtarë dhe cilat vepra ju kanë lënë mbresa më të mëdha?

Periudha letrare shqiptare mes dy luftërave botërore më është dukur më e veçanta. Për disa arsye: konsolidimi i shtetit shqiptar që, gjatë luftërave ballkanike dhe asaj botërore ishte dhe ende nuk ishte në këmbë të veta, filloi të funksionojë si i tillë brenda viteve '20-'30 të shekullit njëzet. Brenda këtij harku kohor, duke u artikuluar si letërsi shqipe brenda shtetit shqiptar, që në hapat e parë shpërtheu si një vlim i akumuluar ndër shekuj. Duke pasur një shekull letrar mbështetje, krijuar qendrave evropiane dhe përtej, këta dy dhjetëvjetësh sikur shpejtonin të thonë tërë të pathënën e botës shpirtërore të kombit. Brenda aq pak hapësire kohore Shqipëria u shndërrua në një kopsht dhe punëtori letrar, shkollash e trendësh krijuese artistike të botës... Dhe, më e rëndësishmja, talente të rinj, emra që shfaqen brenda ditës si të artikuluar së brendshmi, si të gatshëm për të bërë hapa befasisues, duke i dhënë përditshmërisë letrare laramani dhe ritëm të paparë as në historinë e pastajme të letërsisë shqipe. Më e çuditshmja ndërsa, më fatalja mbase për të, për letërsinë, ajo u këput në pikun e këtij premtimi të madh... (është metaforë përmbyllëse e kësaj periudhe, mendimi i Kadaresë që, në studimin e tij për Migjenin thotë: "Uragani i ndërprerë").

Letërsia e huaj po vjen në gjuhën shqipe shpejt, kryesisht nga botuesit e Shqipërisë, ndërkaq letërsia shqipe po depërton jashtë shumë pak. Është letërsi e varfër tematikisht dhe stilistikisht, apo çfarë po ndodh? Mund të na përmendi shkaqet?

Me ritëm të ngjashëm eci letërsia shqipe në Kosovë gjatë dhjetëvjetëshit shtatëdhjetë-tetëdhjetë të shekullit të kaluar. Shtysa e saj

e brendshme, sipas meje, ishte ndjeshmëria për rrezikun që i kanosej etnisë, qenies kombëtare, Kosovës shqiptare nga ripushtimi serb pas Luftës së Dytë. Besimi, entuziazmi i viteve të para pas çlirimit, se më në fund edhe shqiptarët në atë Jugosllavi do të jenë të lirë, të barabartë me të tjerët, filloi të shuhet që nga fundi i viteve pesëdhjetë... Brezi i shkrimtarëve të dytë, që erdh furishëm si talent dhe i formuar intelektualisht - Azem Shkreli, Bokshi, Pashku, Gunga, N. Rrahmani, Gajtani, D. Mehmeti, dhe menjëherë pas tyre Podrimja, S. Hamiti, Z. Rrahmani... tërë fuqinë krijuese të veçantë e përqendruan brenda këtij rreziku të kapshëm, të pranishëm... (Sillni ndërmend shpërnguljet me dhunë të qindra mijë shqiptarë, aksionin famëkeq të mbledhjes së armëve gjatë viteve pesëdhjetë, masakrën e një mijë të rinjve kosovarë në Tivar para kësaj, e plot akte të dhunës tragjike që synonin zhbërjen e Kosovës shqiptare...) Dhe lindi një letërsi e tërë e rezistencës, edhe në kushtet e terrorit dhe censurës së rreptë policore. Në fillim, në poezi, si ndjesi e nevojë për të kërkuar rrënjët e lashta të etnisë, kullën, trungun e natyrshëm në gjuhën ezopike për të qëndruar, për të krijuar vetëbesim në mundësitë e kundërvënies, rezistencës... Duke qenë brez me talent të shquar, e universalizoi vizionin e rezistencës drejt lirisë, krijoi art që sot e tërë ditën qëndron në majat e letërsisë sonë kombëtare... Krahas kësaj letërsie dhe figurshmërisë përkryese të saj, në rininë shqiptare të atyre viteve, sidomos në gjirin studentor të Universitetit të Prishtinës, po me atë ritëm pjekurie u formua lexuesi që komunikonte me gjuhën, me poetikën e kësaj letërsie... Ishte elita letrare e asaj kohe që e para e ndjeu rrezikun e qenies, të etnisë dhe gati se e nxori jashtë vëmendjes refleksin social, shoqëror, intim, erotik të poezisë, në favor të këtij rreziku, në funksion të rezistencës... Prandaj, nga lexuesi i kohës elita letrare u pranua si misionare që i prin rezistencës, misionare drejt një vizioni dhe vetëdijeje të formuar, prandaj mbetet një nga periudhat tona letrare në Kosovë, ngjashëm me atë të viteve tridhjetë që shpërtheu si uragan në Shqipëri e që, më pas, aktualisht, sikur nuk arrijnë të artikulojnë zë aq të fuqishëm përballë kërcënimit të rreziqeve të tjerë, jo më pak kërcënues.

Sigurisht ende i ruani në celular ose në notes numrat e celularëve të miqve që tashmë kanë ndërruar jetë. Kush prej tyre ju mungon më së shumti?

Vazhdoj t'i ruaj numrat telefonikë të miqve tani të ndjerë, Fatos Arapit dhe të Dritëro Agollit.

(Marrë nga numri i gjashtë i revistës "Akademia")

	Autor: GAZMEND MORINA					AFTËSIA E NJERIUT PËR TË KRIJUAR	LLOJ ZOGU KËNGËTAR	▼	FORTESË LIMIT	ERA E MIRË	SHTET I MADH NË AZI	EPOKA E RE	BASHKËT.	OLIVER NEUVILLE	FARMACI	PËREMËR PRONOR	
	QË UA MBATH KËMBËVE NGA FRIKA											HATAJA AKTORI MORINA					
	SËMUNDJE E RËNDE QË SHKAKTOHET NGA PARAZITË SHUMË TË VEGJËL (shq.)												ZULMË TËRHEQJE				
	LLOJ GJARPRI													"RISANI" IZET FETAHAJ			
	GJILANI, ARTANA							MBIEMËR CILËSOR		LETRARI CAMAJ ARIANITI (perkdh.)						EMËRIMI NË NJË POZITË	
	AKTORJA CAHANI												EMËR YNI MASHKULLI NANTES				
	DJALI I VAJZËS										"N" para dy "A" KULAÇE (shq.)				"TORINO"		
PADITËSI I SOKRATIT												DY BASHKËTINGËLLORE "IRLANDA"		OLIVIER MARTINEZ ZANORE			
EPOKA E RE	MANEKINIA SHQIPTARE HITAJ	PËRCAKTIM, PËRKUFIZIM	URANI, KRABONI	SHTET AFRIKAN (pashq.)	PJESËTAR I NJË FISI ILIRI	FORMË E TË HYRAVE SHTETËRORE (shq.)	THEMBRA E KËPUCËS					SHTET AZIATIK (pashq.) DËSHIROJNË					
SJELLJA E NJERËZISHME								ZANORE MJET I THJESHTË PUNE		AKTORI ISLAMI (shq.) ZANORE				ESTONIA, NORVEGJIA KËNGËTAR I NJOHUR AMERIKAN			
FLETA E VOGËL, KU MJEKU SHËNON LLOJET E BARNAVE								SULM E HAPUR				UNIVERSITY OF AUCKLAND			ZANORE FIGURË E RIPRODHUAR E NJË SENDI, SHËMBËLLTYRË		
AGIM TEJECI			LLOJ METALI LUTJE DREJTUAR ZOTIT (mysl.)						KËNGËTARJA ITALIANE PAUSINI	UGANDA POLITIKANI FINLANDEZ ... REHN		ANKESË SONDAZHI					
KËNGËTARJA E NJOHUR SHQIPTARE NË FOTO													ALËN NURI OSAKA	NJËSIA E REZISTENCËS ELEKTRIKE FEMRAT LUFTËTARE (mit. greke)			
BIMË SHUMËVJEÇARE ME TRUNG TË TRASHË				BASHKËT.		KALIBËR I TYTËS SË ARMËS QË VEPRON ME GJALLËRI							SKAJI, QOSHJA ISMET MALAJ			ALBANOLOGIA DURHAM	
GURRA				AMPER, ALUMIN SHKRETËTIRA MË E THATË NË BOTË				DY ZANORE AUSTRIA, ISLANDA			AKTORJA AMERIKANE BASINGER FUTBOLLISTI FRANCEZ NASRI			ZHAN EDUARDSON DISIPLINË SPORTIVE			
EPOKA E RE	ZANORE I THAJ		BËRË ANKESË ANA VISI								LUMË NË SHQIPËRI TËRËSIA E ORENDIVE					BASHKËT. KËNGËTARJA ANGLEZE TANITA	
ZEMËRIM					ORGANIZATA MAFIOZE "..... KINEZE" FARISHTA								PERËNDIA				
QYTET SHQIPTAR NË MAL TË ZI							ANTON PASHKU	KLUB FUTBOLLI ARGJENTINAS "... LORENZO"	SOLISTJA BYTYQI VENDESI				PEZMATIM I VESHIT U PESHOVA				
ERMAL MAMAQI			LLOJ MOTOÇIKLETE QË PRODHOHET NË JAPONI AKTORI CRUISE (shq.)										QË S'KA TJETËR TË NGJASHËM ME TË TË LUTEM			ILAÇI	
BASHKËT.		GOTË PREJ BAKRI KAMION I VOGËL				PEIZAZH I GJERË SPEECH AUSTRALIA PATHOLOGY									ANITA BITRI PËREMËR VETOR		
EPOKA E RE	ISH PRESIDENTI AMERIKAN XHEFERSON NJË E RESHUR						SHEGË TENI ANDERSON				ENË E MADHE PËR TË MBAJTUR QUMËSHT TANTAL						
POTERË (sh.shq.)								MJET PËR SITJE (sh.shq.) SHKRONJA XXIV						RAST BASHKËT.			
PËREMËR PRONOR				KAMPIONI, ASI						DEGË E MJEKËSISË							

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com




QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82



Taulant Xhaka: Para çdo ndeshje flas në telefon me Granitin

BAZEL, 8 GUSHT - Mesfushori i Kombëtares së Shqipërisë dhe Bazelit, Taulant Xhaka, në një intervistë për zvicëranen "www.aargauerzeitung.ch", ka folur për suksesin e fundit ndaj PSV-së, por edhe për ndeshjen që Bazeli e kishte zhvilluar ndaj Manchester Unitedit në Ligën e Kampioneve. Taulanti në këtë intervistë bëri me dije se gjithmonë para ndeshjeve bisedon në telefon me vëllanë e tij, Granit Xhaka. "Jam gjithmonë duke folur në telefon me vëllanë tim, rrugës për në stadium", ka deklaruar Taulant Xhaka.



A ishte ndeshja e kthimit kundër PSV, një nga ato netët magjike?

Xhaka: Sigurisht. Nëse do të kishit pyetur njerëzit para ndeshjes, 70 për qind do të thoshin se PSV do të kualifikohej. Kjo për shkak të skuadrës me të vërtetë të mirë, në të cilën janë lojtarët që kushtojnë 40 milionë euro. Ne si FCB kemi treguar se mund të mposhtim lojtarë të tillë, edhe larg shtëpisë. Pa dyshim, pesë minutat e fundit në Eindhoven nuk ishin të përqendruar sa duhet dhe kjo na kushtoi fitoren. Kthimi në Bazel ka qenë pa dyshim një natë magjike.

Kur e kuptuat gjatë lojës se kjo do të ishte një nga ato netët e famshme magjike?

Xhaka: Në dhjetë minutat e para ndonjëherë vëreini se në cilin drejtim mund të shkojë një lojë. Në këtë rast skuadra jonë ishte e gatshme dhe energjike që nga fillimi. Ne i kishim shanset e para që herët dhe e kuptuam që, nëse nuk shpërdorojmë, do të ishte një natë kaq magjike.

A është gjithashtu thelbësore kimia me lojtarët në një fazë të tillë? A u harmonizuat më mirë këtë mbrëmje sesa zakonisht?

Xhaka: Jo domosdoshmërisht, jo. Përkundrazi, bëhet fjalë për ta bërë të mërzitur njëri-tjetrin. Se të gjithë ata që kanë topin mendojnë të dalin menjëherë në sulm. Kështu mendojnë se e vë kundërshtarin menjëherë nën presion. Por, kur të gjithë duhet të tërhiqeni, e kupton

se çfarë mundësish ke brenda vetes. Kjo është gjëja më e rëndësishme.

Para ndeshjeve të tilla të rëndësishme, skuadra grumbullohet më herët se zakonisht. A është e vërtetë se në ekip dërkë ndihej në ajër?

Xhaka: Unë mendoj se është kështu, me lojtarët më të vjetër si unë, që kanë luajtur lojëra në Ligën e Kampioneve. Ata ndiejnë se çfarë mundësish kanë realisht. Ne provojmë që këtë ndjesi ta përcjellim te lojtarët, që kurrë nuk kanë luajtur në nivel evropian. Iu themi atyre që të mos jenë nervozë, ta luajnë lojën e tyre në të njëjtën mënyrë si në kampionat.

Atëherë, si funksionoi gjithçka ndaj PSV-së?

Xhaka: Është e vështirë të përshkruhet. Në kthimin ndaj PSV ishte dita e të gjithëve, mund ta them këtë. Thjesht, funksionuam si duhet të gjithë, edhe pse kemi pësuar një gol budalla. Kemi luajtur një futboll të shkëlqyeshëm, u vendosëm mjaft mirë nga trajneri. Treguam pasion. Edhe nëse dikush bëri një gabim, të gjithë u hodhën në mbulim të tij.

A ka ndonjë mënyrë të veçantë karikimi, para ndeshjes?

Xhaka: Personalisht nuk bëj asgjë të veçantë. Ne grumbullohem në hotel një ditë më parë, hamë mirë, pimë mirë, e mjaftueshëm. Por, edhe kështu, një nervozizëm i

caktuar ekziston akoma te secili.

A keni rituale para ndeshjes?

Xhaka: Jam gjithmonë duke folur në telefon me vëllanë tim, rrugës për në stadium.

Çdoherë?

Xhaka: Pothuajse gjithmonë. Ai pastaj përpriqet të më japë disa këshilla të fundit. Graniti i njeh klubet e mëdha, tashmë ka luajtur pothuajse kundër të gjithëve.

Çfarë këshillash ju jep?

Xhaka: Ai më thotë se cilin lojtar duhet të shikoj, cili është veçanërisht i shpejtë, teknikisht i fortë, ose tërheq gjithmonë nga brenda. Sigurisht, unë përgatitem taktikisht me ekipin dhe i realizoj vetë këto gjëra në 15 minutat e para të një ndeshjeje. Por, biseda me vëllanë tim, thjesht më ndihmon.

Sidoqoftë, shfaqni njëfarë nervozizmi. Kur ndodh kjo?

Xhaka: Para se të ngrohemi, por jo më pas.

A ka qenë gjithmonë kështu?

Xhaka: Jo, unë ende mund ta kujtoj ndeshjen time të parë, 3-3 kundër Manchester United, në "Old Trafford". Në atë kohë, Thorsten Fink më dha mbështetje morale, sepse në një moment mendova se po pësoja atak kardiak (sulm në zemër). Ishin 70 000 spektatorë në stadium, te Manchester Unitedi luanin futbollistë si Ryan Giggs apo

Paul Scholes. Ata ishin legjenda. U stresova shumë aty, sepse mendova: nëse humbas një top të vetëm, atëherë ai përfundon në portën tonë... Sidoqoftë, në fund gjërat shkuan mirë.

Si luftohet kundër kësaj frike?

Xhaka: Ju duhet të futeni në një përplasje të tillë duke menduar se është ndeshje normale. Nëse nervozizmi bëhet shumë i madh, mposhteni, zhyteni; bëni vetëm pasime të këqija, gjendeni me mendimet e gabuara në vendin e gabuar. Kjo nuk është aq e lehtë, sa duket nga jashtë. Shumë mendojnë se e kemi të thjeshtë të luajmë futboll, por nuk është kështu. Ndeshja në fjalë, kundër Manchester Unitedit, ishte e para e juaja në skenën evropiane dhe e magjishme. Pas asaj keni përjetuar netët të panumërta të tilla.

Cila ishte nata juaj më magjike?

Xhaka: Ka pasur shumë, është e vështirë të zgjedh. Pa dyshim, barazimi 3-3 në Manchester është një prej tyre. Por, edhe barazimi 1-1 në Liverpool mbetet i paharrueshëm. Edhe kthimi kundër PSV-së, gjithashtu. Ju prisni për presion.

Sa ju, si lojtarë, e merrni parasysh se një ndeshje e vetme në Evropë vlen miliona euro, se e ardhmja e skuadrës varet nga ajo?

Xhaka: Ju e keni gjithmonë parasysh këtë gjë, natyrisht. Personalisht, nuk më pëlqen të merrem me llogari të tilla. Mendohem ta kem mendjen të qetë e të qartë dhe thjesht të luaj futboll. Kur viheni nën presion, nuk mund të përqendrohemi.

A e vuajtët presionin pas ndeshjes me PSV-në?

Xhaka: Ju gjithmonë keni presion si futbollist, por nuk është i njëjti presion.

A ndiheni më shumë në presion se të tjerët, sepse jeni zëvendëskapiten?

Xhaka: Nuk ka më shumë presion, por më tepër përgjegjësi në këtë rol. Duhet t'i ndihmoj më të rinjtë

sepse kam qenë në rolin e tyre, 19 apo 20 vjeç.

A i keni përjetuar netët magjike ndryshe nga sot, kur tashmë keni parë kaq shumë prej tyre?

Xhaka: Nuk mendoj kështu. Në çaste të tilla, të gjithë janë gjithmonë të lumtur. Unë isha po aq i lumtur për fitoren ndaj PSV-së, sa në barazimin 3-3 kundër Manchester Unitedit. Kjo ishte e njëjta gjë të martën e kaluar. Edhe ata që nuk luanin prej një kohe të shkurtër ishin aq të lumtur sa pjesa tjetër e ekipit në fushë.

A është bërë skuadra më e fortë, sidomos pas kësaj loje kundër PSV-së?

Xhaka: Sigurisht, në këtë lojë kemi qenë në gjendje ta forcojmë më shumë vetëbesimin. Se mund t'ia dilnim në këtë ndeshje ishte po aq e rëndësishme sa fitorja ndaj PSV-së.

Perceptimi i gjerë është se kampionati zvicëran ka pasur përkeqësim...

Xhaka: Nuk mendoj kështu. Ka shumë talente, shumë lojtarë të rinj të mirë dhe mbi të gjitha shumë lojtarë të uritur. Ndoshta jo me emra të mëdhenj, me shkëlqim. Veç FC Bazeli po rivalizojnë për trofe edhe YB e Cyrih. Edhe të vegjlit janë bërë më të fortë. Në veçanti, taktikisht. Asnjë ekip nuk tërhiqet më. Për shembull, nëse keni parë Servette të luante kundër YB, e besoni këtë që po them.

Sinqerisht, a e njihje më parë Linz?

Xhaka: Unë më siguri kam dëgjuar që ky klub ekzistonte, por nuk i njoh lojtarët e tij.

FC Bazeli, a është favorit ndaj tij?

Xhaka: Ne kemi qenë disa herë në Ligën e Kampioneve dhe, ndoshta, kemi më shumë përvojë si klub sesa ata. Sidomos në këtë nivel. Por, siç thashë, ne nuk duhet ta nënvlerësojmë këtë kundërshtar. Saktësisht, kundërshtarët e tillë janë më të rrezikshmit. Sidoqoftë, ne mund t'ia dalim me sukses në dy ndeshje.

Florent Muslijaj i bashkohet Kosovës

Pas Florent Muslijajt, një tjetër talent i skuadrës gjermane Hannover 96 ka vendosur t'iu bashkohet ekipeve përfaqësuese të Kosovës. Bëhet fjalë për talentin e madh Valdrin Mustafa. "Në emër të KE të FFK-së dhe stafit të ekipeve përfaqësuese, falënderoj ambasadorin

Beq Cufaj dhe stafin e ambasadës në Berlin, Fekmi Kongjelin e Besim Zenelin, si dhe futbollistin Valdrin Mustafa, që pas bisedimeve të për-bashkëta dhe insistimit të këtyre njerëzve dhe FFK-së, vendosi që tash e tutje ta bartë fanellën e 'dardanëve'. Mbi të

gjitha, vlerësoj dëshirën e Valdrinit për të qenë kontribuues për vendin e rrënjëve të tij, për familjen dhe popullin e tij. Po ashtu, një falënderim i veçantë edhe për familjen e këtij futbollisti që e ka rritur atë në frymën patriotike", thuhet në njoftimin e FFK-së.

Ujkani ndahet me Rizesporin

Kapiteni i Përfaqësueses së Kosovës, Samir Ujkani, e ka ndërprerë bashkëpunimin me klubin turk Rizespor. Kontrata e Ujkanit me Rizesporin ishte e vlefshme deri në qershor të vitit 2021, kurse tash portieri shqiptar si lojtar i lirë mund t'i bashkohet ndonjë skuadre

tjetër në këtë afat kalimtar. Ekziston mundësia që Ujkani sërisht të rikthehet në Itali, aty ku e kaloi pjesën më të madhe të karrierës.

Kosova - Luksemburgu zhvillohet në Prishtinë

PRISHTINË, 8 GUSHT - Ndeshja Kosova - Luksemburgu do të zhvillohet më 14 gusht në kuadër të parakualifikimeve për "Eurobasket 2021" në Prishtinë. Ndeshja do të luhet në palestrën e vogël të Pallatit të Rinisë dhe

Sporteve në Prishtinë duke filluar nga ora 20:30. Një vendim të tillë Federata e Basketbollit të Kosovës e ka marrë pas sugjerimeve të FIBA-s të marra menjëherë pas ndeshjes së luajtur të mërkurën mbrëma në

palestrën "Minatori" në Mitrovicë. Në ndeshjen Kosova - Britania e Madhe, për shkak të ngarkesës së madhe të rrymës, është ndaluar semafori, që ka shkaktuar më pas edhe probleme të tjera teknike dhe

organizative dhe kjo ka bërë që ndeshja të ndërpritet. Federata e Basketbollit e Kosovës e falënderon qytetin e Mitrovicës dhe KB Trepçën për gatishmërinë që e kanë treguar në ndihmën organizative të këtyre ndeshjeve.



8 futbollistë kuqezi, pa skuadër dhe të ardhme

TIRANË, 8 GUSHT - Shqipëria do ta sfidojë Francën më shtatë tetor në transfertë, mirëpo kur është ende kulmi i merkatos së transferimeve, për fat të keq, ka një sërë futbollistësh që nuk janë sistemuar ende. Disa prej tyre kanë skuadër dhe janë të shumëkërkuar nga trajnerët, ndërkohë që të tjerë janë jashtë planeve. Ka gjithashtu edhe futbollistë pa një skuadër dhe të lirë. Për të nisur nga mbrojtja drejt sulmit, rezultojnë të paktën tetë lojtarë pretendentë për të qenë në listën e radhës të trajnerit Eduardo Reja, për të mos thënë edhe në planet e tij për formacionin titullar. Elsieid Hysaj është nën kontratë me Napolin dhe për të ka shumë interesime që të largohet, por presidenti De Laurentis është një prej atyre që e ka bllokuar largimin, duke kërkuar jo më pak se 25 milionë euro për kartonin e shqiptarit. Dy mbrojtësit kuqezinj, Arlind Ajeti dhe Ivan Balliu, janë futbollistë të lirë në merkato. I pari ende pa një pistë reale



transferimi, ndërkohë që i dyti është duke vlerësuar ofertat që ka nga Spanja. Frederik Veseli së fundmi refuzoi Turqinë, teksa Empoli e ka nxjerrë jashtë planeve dhe kërkon ta largojë. Sokol Cikalleshi, i cili në grumbullimin e fundit të Kombëtares tregoi se ishte në superformë, për momentin po kalon një shqetësim muskolor. Jo vetëm kaq, por sulmuesi është duke vlerësuar ofertat nga elita turke dhe jo vetëm, duke qenë se nuk ka dëshirë që

të pranojë të luajë në Ligën e Dytë, me gjithë kërkesën nga trajneri i skuadrës. Eros Grezda raportohet sërish me interesime nga Franca, teksa Stiven Gerrard nuk e ka në plane te Rangersi. Kristal Abazaj është një tjetër shqiptar me sytë nga merkato, pasi i ka përfunduar huazimi në Kroaci dhe duket jashtë planeve të Anderlehtit. Armando Sadiku është gjithashtu në kërkim të një destinacioni, teksa trajneri i Levantes nuk e ka në plane.

Williamsi, sportistja më e paguar në botë

UASHINGTON, 8 GUSHT - Tenistja amerikane Serena Williams është sportistja më e paguar femër në botë gjatë periudhës qershor 2018 - qershor 2019. Revista "Forbes" njoftoi sot për sportistet më të paguara femra për periudhën qershor 2018 - qershor 2019. Kampioni i 23 Grand Slam kryesoi listën vjetore të sportistëve femra me pagën më të lartë me të ardhurat totale prej 29.2 milionë dollarësh. Pas fitores së US dhe Australian Opens, Naomi Osaka e Japonisë zuri vendin e dytë në listë me 24,3 milionë dollarë pas Williamsit, ndërsa gjermania Angelique Kerber u rendit e treta me 11,8 milionë dollarë.

LISTA E SPORTISTEVE MË TË PAGUAR:

1. Serena Williams \$29.2 milionë
2. Naomi Osaka \$24.3 milionë
3. Angelique Kerber \$11.8 milionë
4. Simona Halep \$10.2 milionë
5. Sloane Stephens \$9.6 milionë



6. Caroline Wozniacki \$7.5 milionë
7. Maria Sharapova \$7 milionë
8. Karolina Pliskova \$6.3 milionë

9. Elina Svitolina \$6.1 milionë
10. Venus Williams \$5.9 milionë
10. Garbine Muguruza \$5.9 milionë

SHKURT

FC Prishtina, pran anëtarësimit në ECA

Kryetari i FC Prishtina, Remzi Ejupi, priti në takim të enjten shefin e punëve të klubeve të European Club Association, Olivier Jarosz, i themeluar më 2008 nga Andrea Agnelli, pronar i Juventusit. ECA është pasardhëse e ish-grupit të klubeve, e njohur si G-14. "ECA" ka mbi 232 klube në ombrellën e saj, kryesisht klubet më të mëdha nga çdo shtet evropian. Në takim u fol për mënyrën e bashkëpunimit, për detyrimet e asociacionit në fjalë karshi klubeve dhe anasjelltas. "Thjesht edhe një përvojë tjetër e madhe, sidomos në aspektin organizativ të klubeve dhe legjislacioneve juridike të sportit në federatat e shteteve evropiane dhe programeve të ndryshme të bashkëpunimit. FC Prishtina do të jetë së shpejti anëtare e grupimit më të madh të asociacioneve të klubeve në Evropë", thuhet në njoftimin e FC Prishtina.

Ajeti transferohet në West Ham

Sulmuesi shqiptar Alban Ajeti edhe zyrtarisht është lojtar i West Ham Unitedit. Reprerentuesi i Zvicrës ka nënshkruar kontratë katërvjeçare me klubin anglez i cili i ka paguar Baselit 8.7 milionë euro. "Jam shumë i kënaqur që jam këtu. Është një kënaqësi për mua të jem këtu, në këtë klub të madh. Sapo mësova për interesimin e West Hamit, nuk mu desh të mendohesha dy herë për të nënshkruar për këtë klub të madh tradicional në Premierligë. Kjo është një ditë e madhe për mua dhe për familjen time", ka thënë Ajeti.

Duranti: Nuk mund ta fajësoni Warriorsin

Ka qenë muaj i përmbajtur dhe shumë i vështirë për një nga basketbollistët më të mirë në botë. Kevin Durant së pari humbi "play-off" për shkak të një dëmtimi në gju, pastaj lëndoi tendinin e akilit në finale, të cilën nuk do ta luajë sezonin e ardhshëm. Ai u largua nga Golden State Warriors dhe nënshkroi për Brooklyn Nets dhe nuk kishte folur për mediat që atëherë dhe tani ka thyer heshtjen në një intervistë ekskluzive me "Yahoo Sports". "Nuk mund ta fajësoni Warriorsin. Kam dëgjuar që ata më kanë bërë presion që të kthehem sa më shpejt që të jetë e mundur, por askush nuk më tha një fjalë gjatë rehabilitimit. Vetëm unë dhe Rick Celebrini (mjeku kryesor) kemi punuar çdo ditë. Është basketboll, mund të ndodhin. Askush nuk është përgjegjës dhe të gjithë duhet ta lëmë atë pas, sepse do të kthehem dhe do të luaj përsëri", ka thënë Durant.

Crystal Palace nuk e shet Zahan

Anësori i Crystal Palacet, Wilfried Zaha, do të qëndrojë edhe këtë sezon te ky klub. Sipas "SkySports", Crystali i ka bërë të ditur lojtarit se ka marrë fund çdo transferim i mundshëm në këtë afat kalimtar. Zaha kishte kërkuar nga klubi që ta shiste, por Crystali refuzoi disa oferta deri në 70 milionë euro, duke kërkuar edhe më shumë për reprezentuesin e Bregut të Fildishtë.

Leo Duarte: Realizova ëndrrën time

Leo Duarte u zyrtarizua si lojtar më i ri i Milanit për të cilin u derdhën në arkat e Flamengos 11 milionë euro. "Jam shumë i lumtur që jam këtu. Është hera ime e parë në Milano dhe gjithçka është shumë e bukur. Mezi po pres të bashkohem me pjesën tjetër të skuadrës. E shikoja Milanin në Ligën e Kampionëve kur isha i vogël së bashku me babanë tim dhe gjithmonë mbështesja kuqezinjtë", ka thënë Leo Duarte. "Babai im gjithmonë ka qenë një fans i Maldinit dhe unë kam nderin ta shikoj atë nga afër. Kjo është një ëndërr tjetër e cila realizohet. Unë aktualisht admiroj Thiago Silvën, sepse ai është një lojtar më të vërtetë i shkëlqyer. Jam shumë i lumtur tani dhe do të doja ta arrij gjysmën e asaj që ai bëri këtu", ka deklaruar Leo Duarte.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit-Ured Premiera-Office Of The Prime Ministr

Bazuar në nenin 12, paragrafin 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, bazuar në Ligjin Nr. 04/L-077, Për Marrëdhëniet e Detyrimeve, si dhe kërkeses se aprovuar më datë 25/08/2019 me nr. protokollit 34/2019, me qëllim të angazhimit përmes shërbimeve të veçanta, bënë:

Shpallje të konkursit për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta

Emri i Institucionit:	Zyra e Kryeministrit
Njësia Organizative:	Zyra për Qeverisje të mirë
Titulli i punës:	Specialist në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi
Numri i referencës:	ZKM-ZQM-MSHV-001
Tarifë e shërbimit:	E negociuar
Raporton :	Drejtorit të zyrës për Qeverisje të mirë
Lloji i kontratës:	Marrëveshje për Shërbime të Veçanta – (MSHV)
Kohëzgjatja e kontratës:	Gjashtë (6) muaj
Orari i punës:	I plotë
Numri i ekzekutuesve:	1(një)
Vendi:	Prishtinë

Detvat dhe përgjegjësitë e të angazhuarit për MSHV:

1. Siguron udhëzime dhe shërbime këshilluese për mbikëqyrësin mbi politikën dhe praktikën e mundësisë së barabartë e në veçanti për çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtje nga diskriminimi;
2. Ofron këshilla dhe rekomandime për drejtorin në çështjet për mbrojtje nga diskriminimi dhe promovimin për barazinë.
3. Ndihmon në përgatitjen dhe koordinimin e programeve të fushatave për informimin dhe vetëdijësimin e publikut për mundësin e barabartë e në veçanti në vështrimin e ndryshimit të paragjyqimeve dhe avancimin e mundësisë së barabartë dhe mbrojtje nga diskriminimi;
4. Punon në zhvillimin e kornizës së monitorimit për zbatimin e rekomandimeve të avokatit të popullit .
5. Përgatitë raporte pune për periudhen e angazhimit për mbikëqyrësin .
6. Kryen edhe punë tjera që ndërlidhen me fushën për mbrojtje nga diskriminimi ;

Kualifikimi, përvoja e punës dhe aftësitë:

- Diplomë universiteti.
- Përvojë pune profesionale.
- Njohuri e standardeve ndërkombëtare të drejtave të njeriut dhe legjislacionit në fuqi.
- Kërkohej njohuri e punës me kompjuter, Word, Excel punimi i prezantimeve dhe Internet.
- Kërkohej njohja e gjuhës Shqipe dhe /ose Serbe. Njohja e gjuhëve tjera si Anglisht etj është përparësi.
- Të ketë shkathtësi analitike, hulumtuese
- Të jetë energjik, të ketë shkathtësi të mira ndër njerëzore dhe të jetë i/e gatshëm të punojë me orar fleksibil të punës dhe trysni kohe.

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURIMIT

Kandidatët e interesuar për angazhim, për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta, duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- CV-në;
- Letër motivimin;
- Dokumentacionet e parapara në kushtet e punësimit (dëshmitë e kualifikimit profesional, përvojës së punës, referenca dhe çdo dokument tjetër i cili demonstroi dhe vërtetoi përbushjen e kriterëve të fushës përkatëse);
- Certifikatë (dëshminë) që s'është nën hetime;
- Kopje të letërnjoftimit.

Dokumentacionet duhet të jenë në pliko (zarf) të mbyllur dhe të dorëzohen në Divizionin e Personelit , Zyrën e Kryeministrit, sheshi Nëna Terezë, Ndërtesa e Qeverisë, kati IV, zyra nr. 406 ose përmes postës, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda 4 ditësh; aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Konkursin me të dhëna për aplikim, mund ta gjeni edhe në Web faqen : <http://www.rks-gov.net/pm/> ; <http://www.kryeministri-ks.net/zck/>.

Kompensimi është i negociueshëm.

Zyra e Kryeministrit, mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore, nga të gjitha komunitetet.

Do të kontaktohen vetëm kandidatët e përzgjedhur për listën e ngushtë.
Për informata shtesë, ju lutemi telefononi në numrat: 038 200 14 818 dhe 038 200 14 817.

Afati i aplikimit është i hapur 8 ditë nga data e publikimit, nga data 09/08/2019 deri më datën 16/08/2019.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit-Ured Premiera-Office Of The Prime Ministr

Na osnove člana 12. stav 4. Zakona br. 03/L-149 o civilnoj službi Republike Kosovo, na osnovu zakona br. 04/L-077, o obligacionim odnosima, kao i zahtev odobren dana 25/07/2019. godine br. protokol 34/2019, u svrhu angažovanja za posebne usluge, vrši:

Objava konkursa za ugovor o posebnim uslugama

Naziv ustanove:	Kancelarija Premijera
Organizaciona jedinica	Kancelarija za dobro upravljanje
Naziv posla:	Specialista u oblasti zaštite od diskriminacije
Referentni broj:	KP-KDU-UPU-001
Naknada za uslugu:	Pregovara se
Podnosi izveštaj :	Direktoru Kancelarije za dobro upravljanje
Vrsta ugovora:	Ugovor o posebnim uslugama – (UPU)
Trajanje ugovora:	Šest (6) meseci
Radno vreme:	Puno
Broj izvršioaca:	1(jedan)
Mesto:	Priština

Dužnosti i odgovornosti angazhovanih UPU:

1. Pruža nadzorne i savetodavne usluge nadzorniku u pogledu politika i praksi jednakih mogućnosti, posebno u vezi sa pitanjima koja se odnose na zaštitu od diskriminacije;
 2. Daje savete i preporuke direktoru u pitanjima zaštite od diskriminacije i unapređenja jednakosti.
 3. Pomaže u pripremi i koordinaciji programa kampanji za informisanje i podizanje svesti javnosti o jednakim mogućnostima, posebno u pogledu uočavanja promene predrasuda i promovisanja jednakih mogućnosti i zaštite od diskriminacije;
 4. Radi na razvijanju okvira za praćenje sprovođenja preporuka ombudsmana.
 5. Priprema za nadzornika izveštaje o radu za period angažovanja.
- Vrši i druge aktivnosti koje se odnose na oblast zaštite od diskriminacije

Kvalifikacija, radno iskustvo i veštine:

- Univerzitetsku diplomu.
- Profesionalno radno iskustvo.
- Poznavanje međunarodnih standarda ljudskih prava i važećeg zakonodavstva.
- Potrebno je poznavanje rada na kompjuteru, Wordu, Excelu, veština izrade prezentacija i rada na Internetu.
- Potrebno je znanje albanskog i / ili srpskog jezika. Poznavanje drugih jezika poput engleskog i drugih predstavlja prednost.
- Treba posedovati analitičke, istraživačke veštine
- Treba biti energičan, da poseduje dobre međuljudske veštine i bude spreman za rad uz fleksibilno radno vreme i pod vremenskim pritiskom

OPŠTE INFORMACIJE ZA KANDIDATE U VEZI SA PROCEDURAMA ZA KONKURISANJE

Kandidati zainteresovani za angažovanje, za ugovor o posebnim uslugama trebaju priložiti sledeća dokumenta:

- Biografiju
- Motivaciono pismo.
- Dokumentaciju predviđenu za zapošljavanje (dokaz o stručnoj kvalifikaciji, radnom iskustvu, referencama i bilo koji drugi dokument koji potvrđuje ispunjavanje kriterijuma u relevantnoj oblasti
- Potvrda (dokaz) da nije pod istragom.
- Državljanin Kosova (kopija lične kartice).

Dokumentacija treba da bude u zapečaćenim kovčevima i da se podnese Kadrovskoj jedinici, u Kancelariji premijera, Trg Majke Terezije, Zgrada Vlade, IV sprat, kancelarija br. 406 ili poštom, sa poštanskim pečatom na pošiljci stavljenim poslednjeg dana roka za prijavu, smatrat će se važećim i razmatrat će se ako stignu u roku od 4 dana; prijave koje stignu nakon ovog roka i nepotpune prijave se odbijaju.

Konkurs sa podacim za aplikaciju možete naći na web stranici: <http://www.rks-gov.net/pm/>; <http://www.kryeministri-ks.net/zck/>.

Naknada je po dogovoru.

Kancelarija premijera pozdravlja prijave svih muških i ženskih osoba iz svih zajednica.

Biće kontaktirani samo kandidati koji su ušli u uži izbor.

Za dodatne informacije pozovite na brojeve telefona 038 200 14 818 i 038 200 14 817.

Rok za prijavu je otvoren 8 dana od dana objave, od 09 / 08 / 2019. do 16/ 08/ 2019. godine.



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo - Tax Administration of Kosovo



Njoftim për tatimpagues

ATK, ju rikujton se Vendimi Shpjegues Publik Nr. 02/2019 përcakton trajtimin tatimor të Kontratave Afatgjate Ndërtimore

Administrata Tatimore e Kosovës, ju rikujton se në muajin shkurt/2019 ka nxjerrë Vendimin Shpjegues Publik Nr. 02/2019 për trajtimin tatimor të kontratave afatgjate ndërtimore.

Qëllimi i këtij Vendimi Shpjegues Publik është që të sqarojë trajtimin tatimor për aspekte të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), Tatimit në të Ardhura Personale (TAP) dhe Tatimit në të Ardhura të Korporatave (TAK), të kontratave afatgjate ndërtimore.

Ky Vendim Shpjegues Publik vlen për personat e angazhuar në aktivitetet e ndërtimit, gjegjësisht tatimpaguesit të cilët merren me projektet dhe kontratat afatgjate të ndërtimit.

Vendimin Shpjegues Publik Nr. 02/2019 për trajtimin tatimor të kontratave afatgjate ndërtimore, mund ta gjeni në ueb faqen e ATK-së www.atk-ks.org në linkun [Publikime – Shpjegimet Publike](#).

ATK, në bashkëpunim me FMN, në implementim të Projektit "Përbushja në Sektorin e Ndërtimitarisë"!

Administrata Tatimore e Kosovës



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Univerzitetste Bolničke i Kliničke Sluzbe Kosova (UBKSK)
Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
Qendra Klinike Universitare e Kosovës – Universiteti Klinicki Centar Kosova –
University Clinical Center of Kosovo
Sektori i Personelit

Nr.Ref. 1684/19, datë 08.08.2019.

Në bazë të nenit 13 pika 3 e Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës, nenit 13 pika 1 e Statutit të QKUK-së, dhe Vendimit të Inspektoratit të Punës 01 Nr.60-63/2019 nr. 3896/2 datë 05.08.2019, Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së, nxori këtë:

V E N D I M Për Anulim të Pjesërishëm të Konkursit publik,

- I. **Anulohet Pjesërisht** Konkursi publik nr. 235, datë 19.02.2019 për **Drejtore në Departamentin e Infermierisë të QKUK-së (pozita e parë), ndërsa pozita e dytë e këtij konkursi mbetet e pa ndryshuar;**
- II. Obligohet Sektori i Personelit për zbatimin e këtij Vendimi;
- III. Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Me Vendimin e Inspektoratit të Punës 01 Nr.60-63-1/2019 më nr. 3896/2 datë 05.08.2019, kërkohet ndër të njëra edhe Anulimin e pjesërishëm të Konkursit Publik me nr. ref. 235 të datës 19.02.2019.

Prandaj, Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së, në bazë të kompetencave, konform ligjit në fuqi dhe Vendimit të Inspektoratit të punës në fjalë, lejon anulimin e pjesërishëm të Konkursit publik dhe kërkohet që i njëjti të publikohet sa më parë që të jetë i mundur.

Me sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

VENDIMI T'Ë DORËZOHET
✓ Zyrës së personelit,
✓ Një mediumit informativ.
✓ Arkivit.

Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së

Dr. Basri Sejdiu

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► "Auto-Taxi" shpall të pavlefshëm certifikatën e regjistrimit të biznesit më numër: 810468604 dhe nr.fiskal: 600410609.

► N.T. "Baholli Colors" nga Prishtina shpall të pavlefshëm certifikatën e regjistrimit të biznesit më numër: 80077629, nr.fiskal: 600019386 dhe nr.TVSH: 330039174.

► Adis Sofiu shpall të pavlefshëm dëftesat dhe diplomën certifikatën e maturës të lëshuar nga SH.M.M. "Luciano Motroni" Prizren.

► Floriana Cikaqi shpalle te pavlefshëm dëftesat dhe diplomën e gjimnazit "Remzi Ademaj" Prizren.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkohet një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Shitet banesa në Lakërishte përballë Procredit Bankës, hyrja e parë kati i 9 banesa ka 50m2 me dokumentacion të rregullt, çmimi 52 000€. Për info 044/672-439.

► Lëshohet me qira banesa në lakërishte afër Procredit bankës është e mobiluar 50m2 për një çift çmimi është 220€. Për info 044/672-439.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Univerzitetste Bolničke i Kliničke Sluzbe Kosova (UBKSK)
Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
Qendra Klinike Universitare e Kosovës – Universiteti Klinicki Centar Kosova –
University Clinical Center of Kosovo
Sektori i Personelit

Nr.Ref. 1684/19, data 08.08.2019.

U sklado sa članom 13 stav 3 Statuta Kosovske bolnice i službe za kliničku bolnicu, članom 13 tačka 1 Statuta UKCK, i Odluke Inspektorata rada 01 br. 60-63/2019 br. 3896/2 od 05.08.2019. godine, Generalni Direktor UBKSK-a izdao je sledeće:

ODLUKA Za delimično poništenje javnog konkursa,

- I. Delimično ponistava javni konkurs br. 235, od 19.02.2019. Za Direktora Departamenta za Sestrinstvo UKCK (prva pozicija), dok druga pozicija ovog konkursa ostaje nepromenjena;
- II. Sektor kadrova je obavezan da primeni ovu Odluku;
- III. Ova odluka stupa na snagu danom potpisivanja.

Obrazloženje

Rješenjem Inspektorata rada 01 br. 60-63-1 / 2019 br. 3896/2 od 05.08.2019. Godine, između ostalog, traži se delimično otkazivanje Javnog konkursa br. Ref. 235 od 19.02.2019.

Shodno tome, Generalni Direktor UBKSK, prema nadležnostima, i prema važećem zakonu i Odluka predmetne Inspekcije rada omogućava delimično otkazivanje javnog konkursa i zahteva da se on objavi što je pre moguće.

Kao što je već navedeno, odlučeno je kao u dispozitivu ove odluke.

ODLUKA KOJI SE PODNOSI
* Kancelarija za kadrove,
* Informacioni medij.
* Arhiva.

Generalni Direktor UBKSK.

Dr. Basri Sejdiu



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

